



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 6 regjistër (JR)
Datë 14.02.2024

Nr. 82 i vendimit
Datë 12.11.2025

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 12.11.2025, ditën e mërkurë, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Bautier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 6/2024 (JR), datë 14.02.2024, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 724, datë 13.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Agovi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet në ankim nga Komisionerja Publike, e cila kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 724, datë 13.12.2023, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, si dhe dëgjoi parashtrimet e palëve dhe analizoi kërkimet në bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit objekt ankimi dhe pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, dhe të subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit,

dëgjoji gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, dhe e bisedoi atë në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Agovi ushtron detyrën e prokurorit nga viti 2001. Për këtë arsye, me hyrjen në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin Arben Agovi, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), nga të cilat rezultoi se:
 - 2.1. ILDKPKI-ja¹, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Arben Agovi”, referoi se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë dhe (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2. DSIK-ja², bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, konstatoi *përshtatshmërinë* për vazhdimin e detyrës.
 - 2.3. KLP-ja³, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Pasi kreu hetimin administrativ, me vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni *konfirmoi* në detyrë subjektin e rivlerësimit, pasi konkludoi si vijon për secilin kriter.
 - 3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni konstatoi një pamundësi financiare në vlerën prej (-) 765.210 lekësh për periudhën 1993 – 2016, për shtimin e pasurive dhe likuiditeteve, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera. Në zbatim të parimit të proporcionalitetit, Komisioni konkludoi se kjo mungesë burimesh nuk është problematike, dhe referuar jurisprudencës së

¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 18.12.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Arben Agovi”.

² Shkresa nr. {***} prot., datë 25.9.2023, “Dërgohet njoftimi [...]”, i deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. {***}, datë 20.9.2023.

³ Shkresa nr. {***} prot., datë 23.5.2023, “Raport për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Arben Agovi”.

Kolegjit, nuk mund të konsiderohet si deklaram i pamjaftueshëm sipas pikës 3 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Në vlerësim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, arriti nivel të besueshëm për këtë kriter.

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni nuk konstatoi problematika dhe konkludoi se subjekti ka arritur nivel të besueshëm.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv. Gjetjet e konstatuara lidhur me disa denoncime, Komisioni nuk i konsideroi si tregues të një problematike thelbësore, që do të çonte në penalizimin e subjektit në vlerësimin e aftësive profesionale. Për këto arsye, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, vlerësohet “i aftë” dhe ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të gurmës “c” të pikës 1, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit të sipërcituar, ushtroi ankim Komisionerja Publike Irena Nino, e cila kërkoi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) ndryshimin dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Sipas Komisioneres Publike, në një vlerësimin tërësor të çështjes, sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, balanca negative prej (-) 765.210 lekësh e konstatuar nga Komisioni dhe mangësitë në kriterin e aftësive profesionale, janë të tilla që e përjashtojnë mundësinë e konfirmimit të subjektit në detyrë. Konkretisht, Komisionerja Publike parashtron se subjekti i rivlerësimit duhet të shkarkohet nga detyra pasi:

4.1. Për mangësitë në kriterin e aftësive profesionale, të metat e konstatuara në shqyrtimin e dosjeve të trajtuara gjatë procesit, të analizuara si pasojë e denoncimeve, janë të përsëritura dhe duhet të vlerësohen negativisht, e nuk shërohen nga programi i trajnimit të Shkollës së Magjistraturës.

4.2. Rrethanat që rezultojnë nga denoncimet, si: moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, mënyra jokorrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2, 3 dhe nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe reflektojnë mangësi profesionale që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Si të tilla, këto mangësi duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave të çështjes së subjektit të rivlerësimit, në këndvështrim të perceptimit të publikut për mënyrën se si funksionon drejtësia, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

5. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të

Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit Ë, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur të konfirmojë në detyrë subjektin e rivlerësimit Arben Agovi, për të cilin Komisionerja Publike, nëpërmjet ankimit, kërkon ndryshimin e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankueses

6. Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

7. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi në Kolegj, i ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 724, datë 13.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, zhvillohet në seancë gjyqësore publike.

7.1. Për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerëve Publikë, trupi gjykues i Kolegjit vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme⁴. Në seancën publike të zhvilluar në datën 28.10.2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, u përfaqësua, sipas autorizimit nr. {***} prot., datë 22.10.2025, nga prokurori Klodjan Braho.

7.2. Në parashtrimet në Kolegj dhe në bisedimet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nëpërmjet përfaqësuesit të tij me autorizim, kërkoi ndryshimin e vendimit objekt ankimi dhe pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës. Në këtë vlerësim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u fokusua në sa rezulton në analizën e tij për gjashtë prej procedimeve penale, ndërsa për dy të tjerë nuk konstatoi problematika. Pamjaftueshmëria financiare në vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, bazuar në parimin e proporcionalitetit, është e pamjaftueshme që të ndikojë në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

7.3. Subjekti i rivlerësimit dha shpjegimet e tij për secilën çështje të ankimuar, duke argumentuar se ankimi është formal dhe i pabazuar. Sipas subjektit, pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni nuk mund të afektojë kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe jurisprudencës së Kolegjit. Subjekti pretendoi se Komisionerja Publike përpiqet të paraqesë një situatë pamjaftueshmërie që nuk ekziston dhe nuk mund të ndikojë në vendimmarrjen e Kolegjit, që investohet me shkaqe ankimi lidhur vetëm me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Në përfundim, duke marrë parasysh që në ankim nuk evidentohen mangësi konkrete dhe shkaqe të mjaftueshme që do të ndikonin në një vlerësim penalizues për subjektin e

⁴ Në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile.

rivlerësimit, përfaqësuesi ligjor i subjektit kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit.

B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm i Apelimit

8. Në përfundim të procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, pasi dëgjoi palët dhe analizoi aktet e administruara në cilësinë e provës në hetimin gjyqësor, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit është i drejtë. Disa mangësi të konstatuara në procedimet penale të analizuara në Kolegj, nuk paraqesin gjykime të cekëta apo një mënyrë pune të papajtueshme me pozicionin nga ana e subjektit të rivlerësimit. Si të tilla, ato nuk mund të konsiderohen të një serioziteti që do të passillte nevojën për detyrimin e subjektit të rivlerësimit t'i nënshtrohej programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës. Në vijim, shtjellohet në mënyrë të përmbledhur, arsyetimi mbi të cilin u bazua ky konkluzion.

8.1. Nga kontrolli i 6 (gjashtë) çështjeve/procedimeve penale, në analizën e të cilave u bazua qëndrimi përfundimtar i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues i Kolegjit vëren disa mangësi në katër (4) prej tyre. Konkretisht, në çështjet penale që lidhen me: (i) denoncimin e z. Gj. Ç.; (ii) denoncimin anonim, datë 18.01.2022 [lidhur me kallëzimin e znj. A. S. në vitin 2018]; (iii) denoncimin nga znj. P. P.; dhe (iv) denoncimin e z. F. C., trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti ka treguar disa mangësi në formën e vonesave apo moskryerjen e ndonjë veprimi të caktuar hetimor në dobi të hetimit, si dhe në zbatimin e gabuar të ligjit, pa marrë parasysh ndryshimin që kishte pësuar dispozita materiale penale.

8.2. Nga ana tjetër, për dy çështjet e tjera që lidhen përkatësisht me denoncimin e z. E. K. dhe atë të z. A. S., trupi gjykues i Kolegjit nuk evidentoi të pasqyrojnë arsyetime të gabuara, paaftësi për të ndërmarrë hetimin, mungesë hetimesh apo zvarritje që kanë dëmtuar interesat e palëve. Nga analiza e veprimeve hetimore që rezultojnë nga aktet në fashikull dhe shpjegimet në proces, rezulton që subjekti të ketë kryer hetime të gjithanshme për të zbardhur dinamikën e ngjarjeve, administruar akte, pyetur personat që kishin dijeni, dhe sipas rastit, disponuar e administruar edhe aktekspertime për të qartësuar nëse pretendimet e kallëzuesit provonin rrethanat që pretendonin vepër penale.

8.3. Trupi gjykues vëren se subjekti ka qenë rigoroz dhe i angazhuar për të kryer një sërë veprimesh hetimore për të zbuluar dinamikën e rrethanave faktike dhe ka identifikuar edhe personat përgjegjës. Subjekti rezulton të ketë marrë në pyetje disa herë individët të cilët kishin/mund të kishin dijeni për hetimin, ka konstatuar personat përgjegjës për veprat penale të shpërdorimit të detyrës dhe ka mbajtur kontakte rregullisht me palët në procese, për t'i azhurnuar me veprimet e kryera. Duke mbajtur në konsideratë veprimet e shumta hetimore të kryera prej tij, si dhe që njëri prej procedimeve ishte i provuar të ishte edhe përtej kufijve të parashkrimit të ndjekjes penale, trupi gjykues i Kolegjit vëren se rrethanat e pretenduara në këto dy denoncime nuk tregojnë mangësi profesionale apo sjellje që kanë dëmtuar interesat e individëve apo të shtetit për të dhënë drejtësi.

8.4. Për sa u përket 4 (katër) çështjeve për të cilat edhe trupi gjykues i Kolegjit konstatoi disa mangësi, disponimi me një masë disiplinore dhe detyrimi për të ndjekur një program trajnimi u vlerësua në disproporcion me natyrën e peshën e tyre [mangësive]. Konkretisht, në dy prej këtyre

çështjeve, subjekti i rivlerësimit ka treguar vonesë, përkatësisht në transferimin e procedimit penal për shkak të mungesës së kompetencës lëndore [procedimi nr. {***}/2019] dhe në përfundimin e hetimit [në procedimin nr. {***}/2019].

8.4.i. Nga analiza e akteve dhe kronologjisë që rezulton prej tyre, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti nuk shpjegoi qartë arsyet për vonesën në transferimin e një procedimi penal [që lidhet me denoncimin e z. Gj. Ç.]. Në kushtet që ky procedim ishte në ngarkim edhe të disa funksionarëve publikë, përfshirë edhe një ish-zyrtar të lartë të qeverisjes vendore, vonesa në kalimin e akteve Prokurorisë së Posaçme për shkak të moskompetencës lëndore, pas administrimit të aktit të ekspertimit të hartuar, në perceptimin e publikut në kontekstin e pandëshkueshmërisë, merr rëndësi të veçantë në kontekstin e mënyrës sesi funksionon sistemi i drejtësisë. Pavarësisht nga ky konstatim, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi atë me pasoje të reduktuar në këtë proces, pasi vëren se subjekti ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, përfshirë edhe aktin e ekspertimit dhe mbi të gjitha, në pikën fundore, ia ka nënshtruar çështjen hetimit nga institucioni përkatës, duke mos passjellë pasoja të dëmshme për zbardhjen e ngjarjes apo favorizuar të dyshuarit. Po ashtu, edhe fakti që një pjesë e vonesës gjatë procesit në fjalë përkon me mbylljen për shkak të masave të jashtëzakonshme të pandemisë së Covid-19, u përfshi në këtë konkluzion të trupit gjykues.

8.4.ii. Në procedimin e dytë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi vonesën e konstatuar në kryerjen e veprimeve hetimore dhe përfundimin e hetimit, me peshë të *reduktuar* në kontekstin e volumit të akteve që nevojitej të administroheshin, apo ngarkesës së shtuar që ka përballuar institucioni i prokurorisë në vitet në fjalë.

8.5. Në dy çështjet e tjera në të cilat u konstatuan mangësi në drejtim të kryerjes së disa veprimeve hetimore specifike, trupi gjykues i Kolegjit vëren sa vijon:

8.5.i. Në çështjen penale të hetuar mbi bazën e kallëzimit të znj. P. P., dinamika e veprimeve dhe e drejta e mohuar denoncueses ishte vënë në vend nëpërmjet procesit civil të iniciuar prej saj për të rifituar të drejtat nga pasuria e krijuar gjatë martesës. Në këto kushte, ndonëse trupi gjykues i Kolegjit vëren se efekti fundor i këtyre mangësive nuk passillte pasoja për vetë denoncuesen, e cila kishte rezultuar gjyqfituese në procesin civil të përfunduar përpara kallëzimit penal të ushtruar prej saj, subjekti nuk rezulton të ketë marrë në pyetje e të ketë zbardhur tërësisht dinamikën e hartimit të akteve që u kontestuan si të falsifikuara, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, qoftë në ndërmarrjen e veprimeve hetimore të logjikshme, përcaktuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

8.5.ii. Në çështjen e përlllogaritjes së dënimit me kusht për të pandehurin A. R. [denoncimi anonim lidhur me kallëzimin e znj. A. S., datë 31.07.2018], subjekti i rivlerësimit ka kërkuar një dënim alternativ *nën* kufirin minimal 24-mujor, të përcaktuar me ndryshimet që ka pësuar neni 59 i Kodit Penal në vitin 2017. Me këtë kohëzgjatje ka rënë dakord edhe gjykata. Subjekti po ashtu duket se nuk ka hetuar gjithë rrethanat që rezultonin nga akti i ekspertimit të kryer, që konfirmonte dhunën fizike të ushtruar ndaj kallëzueses. Këto rrethana, pavarësisht nga shpjegimet e sjella nga subjekti, u çmuan me peshë në analizën e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit, pasi tregojnë mangësi në aspektin e njohurive ligjore, në ndërmarrjen e veprimeve hetimore të logjikshme, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe për të interpretuar ligjin, përcaktuar në nenin 73, pika 2 të ligjit nr. 96/2016.

B.I. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për secilën çështje objekt ankimi

9. Denoncimi i z. N. K., nr. {*}, datë 24.7.2019:**

9.1. Komisionerja Publike pretendon në ankim se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin për të mbledhur provat dhe ka treguar mungesë të analizës dhe argumentit logjik. Subjekti nuk ka kryer hetim të plotë për qartësimin e rrethanave të kallëzimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 73 të ligjit nr. 76/2016. Konkretisht, Komisionerja Publike, pretendon se:

(i) Subjekti nuk respektoi udhëzimet e gjykatave, për hetimin e detajuar rreth përdorimit të dokumenteve të falsifikuara pas qershorit të vitit 2006, kur rezulton se këto dokumente janë përdorur në kontrata shitblerje apo edhe pranë institucioneve bankare, më së paku në vitin 2008, duke sjellë pasoja dhe përfitime për palët e tjera të përfshira.

(ii) Subjekti nuk dha shpjegime bindëse mbi mungesën e konkretizimit dhe saktësisht të veprimeve hetimore në urdhrin e nxjerrë prej tij, si dhe për mungesën e mbikëqyrjes së veprimeve të Oficerit të Policisë Gjyqësore (në vijim “OPGj”).

(iii) Argumentet e subjektit për mungesën e hetimit rreth çmimit të shitblerjes së tokës dhe vlerës së saj në kontratën e hipotekimit, nuk qëndrojnë. Nga aktet kishte të dhëna të mjaftueshme/indicie për verifikime të mëtejshme të transaksionit dhe vlerës së dyshimtë të tij nga palët e kallëzuara. Subjekti kishte për detyrë të kryente hetime të thelluara për kualifikimin e saktë të veprës penale dhe personave përgjegjës, duke mos e neglizhuar si rezultat i kalimit të afateve të parashkrimit.

9.2. Denoncuesi ka paraqitur në Komision rrethanat që lidhen me një kallëzim për veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve” dhe të “shpërdorimit të detyrës”, pasi ka pretenduar se i kallëzuar i mori pronësinë pa të drejtë. Denoncuesi pretendon që e ëma kishte trashëguar tokë, arë dhe truall, nga babai i saj (gjyshi i denoncuesit), njohur dhe kthyer nga ish-Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të ish Pronarëve Lezhë, sipas vërtetimit hipotekor nr. {***}, datë 13.12.1996, me sipërfaqe 7.500 m². Kallëzuesi pretendon se kryetari i fshatit {***}, Kryetari i Komunës, Regjistruesi në Zyrën Vendore Lezhë dhe topografi, në vitin 2003, ia kanë dhënë pronën e tij një personi tjetër [z. N. T.] nëpërmjet një akti të falsifikuar. Denoncuesi pretendon se subjekti nuk duhet të kishte kërkuar pushimin e çështjes, por duhet të kryente një hetim më të plotë në drejtim të: (i) saktësisht të pozitës procedurale dhe pyetjes së disa punonjësve të tjerë që mund të ishin implikuar në këtë procedim, të ndryshëm nga ato që kallëzoi; (ii) duhej hetuar në drejtim të faktit se si prona u la peng/hipotekë për sigurimin e një kredie prej 3,6 milionë lekësh, ndërsa duhet të hetohej edhe shitja prej 500.000 lekësh; dhe (iii) në dosje nuk ka një relacion shpjegues të OPGj-së për faktin dhe provat, si dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të çështjes.

9.3. Pas administrimit të akteve dhe analizës së shpjegimeve të subjektit në përgjigje të barrës së provës, Komisioni konkludoi në vendim se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse. Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore në këtë çështje që lidhen me subjektin e rivlerësimit nga momenti që filloi hetimet.

9.4. Nga aktet që ka administruar Komisioni, konstatohet se, mbi bazën e kallëzimit të z. N. K., është regjistruar procedimi penal nr. {***}, datë 13.1.2016, për të njëjtat vepra penale të kallëzuara [të “falsifikimit të dokumenteve” dhe të “shpërdorimit të detyrës”]. Fillimisht materiali u trajtua nga një prokuror tjetër [M. B.], i cili kërkoj pushimin për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale

dhe se çështja po trajtohej nga organet administrative⁵. Kundër këtij vendimi, ushtroi ankim denoncuesi, duke pretenduar se hetimet nuk janë të plota dhe se prona është tjetërsuar nga veprimet e kundërligjshme të personave përgjegjës në administratën shtetërore. Më tej, pasi çështja u rikthye për plotësim hetimesh, u trajtua nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka regjistruar procedimin dhe ka kryer veprimet hetimore, në përfundim kërkoi para gjykatës pushimin e çështjen.

9.4.i. Gjykata e Shkallës së Parë, Lezhë, vendosi të shfuqizojë vendimin e pushimit të procedimit penal dhe të urdhërojë prokurorinë që të vijojë hetimet. Gjykata e Apelit Shkodër, në vendimin e datës 16.11.2017, arsyetoi se vendimi i pushimit është marrë pa u kryer verifikime dhe hetimet e nevojshme dhe la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Në lidhje me parashkrimin e veprës penale, Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, arsyetoi se veprimet që kundërshton janë kryer nga viti 2003 – 2006 (që është momenti i lëshimit të certifikatës së pronësisë), por edhe më pas janë kryer veprime mbi këtë pasuri. Në këto kushte, vijon gjykata, duhet të ishin verifikuar veprimet konkrete dhe koha e kryerjes së tyre për të konkluduar nëse ndodhemi përpara parashkrimit të ndjekjes penale.

9.4.ii. Pasi iu caktua çështja, në datën 13.4.2018, subjekti i rivlerësimit vendosi rifillimin e hetimeve dhe në datën 3.4.2019, paraqiti para gjykatës kërkesën për pushimin e çështjes penale në fjalë, me arsyetimin se është parashkruar ndjekja penale. Subjekti, ndër të tjera, ka administruar në dosje edhe vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë nr. {***}, datë 1.12.2015, me palë paditëse nënën e denoncuesit⁶ dhe të paditur personin që pretendon denoncuesi se i ka marrë pronën pa të drejtë. Në këtë gjykim [të vitit 2015], paditësja kërkoi konstatimin absolutisht të pavlefshëm të AMTP-së së vitit 2003 në emër të z. N. T. Në përfundim të gjykimit, është vendosur rrëzimi i padisë së paditëses D. K. (e ëma e denoncuesit). Ky vendim u prish dhe çështja u dërgua për rigjykim në shkallë të parë për të rregulluar ndërgjyqësinë – thirrjen e Ministrisë së Ekonomisë në gjykim. Pasi ka administruar aktet e nevojshme nga institucionet përgjegjëse dhe ka realizuar marrjen në pyetje personat për plotësimin e hetimeve sipas urdhërimeve të gjykatës, subjekti ka vijuar me paraqitjen e kërkesës për pushim të çështjes, duke arsyetuar se nga hetimet e kryera rezultoi të jemi para disa veprave penale, për të cilat është regjistruar procedimi, konkretisht “falsifikimit të dokumenteve” dhe “shpërdorimit të detyrës”. Subjekti ka konstatuar konsumimin e veprës penale të “shpërdorimit të detyrës” nga Kryetari i Komisionit të Ndarjes së Tokës, që ka lëshuar AMTP-n e vitit 2003, *që është në një linjë me konstatimin e vendimit të Prefektit Lezhë për anulimin e këtij akti*. Gjithashtu, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe për Kryetarin e Komunës {***}, duke u shprehur se ai ka konsumuar të njëjtën vepër penale, pasi nuk kishte detyrë funksionale që të nënshkruajë vërtetime pronësie. Subjekti thekson se AMTP-ja është lëshuar në datën 24.2.2003, ndërsa vërtetimi i regjistrimit në datën 20.3.2003, e konstatoi se janë kryer

⁵ Në fakt, në vitin 2017, në shqyrtimin e kërkesës së datës 29.1.2016, të nënës së denoncuesit, Prefekti i Qarkut Lezhë, vendosi deklarimin e pavlefshmërisë së plotë ligjore të AMTP-së së vitit 2003. Ky kontroll është ushtruar nga Prefekti mbi bazën e kërkesës së nënës së denoncuesit, në kuadër të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë” dhe të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të strukturave shtetërore të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

⁶ Ky element u mbajtur në konsideratë nga trupi gjyqësor për të shpjeguar rrethanat e faktit dhe se kishin mundësi ta kërkonin zgjidhjen penalisht që në 2015, para se të parashkruhej.

veprime të kundërligjshme. Nën dritën e nenit 248⁷ të Kodit Penal, subjekti vlerësoi se ato tejkalojnë afatin 10-vjeçar të ndjekjes nga momenti i kallëzimit, sipas germës “b”⁸, të pikës 1, të nenit 66 të Kodit Penal (para ndryshimeve të vitit 2017).

9.4.iii. Për zyrtarët e tjerë dhe personat e tretë [referuar shitblerjeve të mëvonshme], në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit që arsyetoi [për kërkesën e prokurorit tjetër] se duhet të ishin verifikuar veprimet konkrete dhe koha e kryerjes së tyre, që më pas të arrihej në konkluzionin nëse ndodhemi para parashkrimit, subjekti konstatoi veprimet konkrete dhe momentin e kryerjes nga secili funksionar publik. Për ish-Përgjegjësën e Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarkun Lezhë, subjekti konkludoi se miratimi i AMTP-së i vitit 2003 dhe procesverbalit të dorëzimit të AMTP-së është i datës 1.6.2006 dhe, pas rifillimit të hetimeve, rezultoi se ky person e ka konsumuar veprën penale në cilësinë funksionale që kryente, por këto veprime janë kryer në vitin 2003 dhe 1.6.2006, që nënkupton që kanë kaluar 10 vjet e, për pasojë, nën dritën e dispozitës së kohës në fuqi, nuk mund të ushtrohet ndjekja penale. Me fjalë të tjera, subjekti arsyetoi se pavarësisht se këta persona e kanë kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës, në bazë të nenit 3⁹ të Kodit Penal nuk mund të ushtrohet ndjekja.

9.4.iv. Subjekti arsyetoi se AMTP-ja e vitit 2003 është lëshuar në kundërshtim me ligjin nr. 7501/1991 “Për tokën”, pasi konstatohen elementet e shpërdorimit të detyrës nga personat e ngarkuar me funksion publik. Subjekti arsyetoi më tej se z. N. T. është vënë në posedim të një akti me të dhëna jo të sakta, fakt për të cilin është në dijeni që në radhë të parë se nuk duhet ta posedonte e të kryente veprime të mëtejshme. Subjekti konstatoi se ky akt/AMTP-ja u përdor nëpërmjet aplikimit në ZVRPP Lezhë në datën 22.6.2006, nëpërmjet shitjes në datën 19.10.2006, e regjistrimit nga regjistruesi në datën 12.12.2006. Për poseduesin e AMTP-së së paligjshme, N. T., subjekti arsyetoi se ka konsumuar elementet e falsifikimit të dokumentit, por për shkak të parashkrimit, pas rifillimit të hetimeve, nuk mund të ushtrohet ndjekja penale. Edhe për punonjësit e tjerë të ZVRPP Lezhë, pasi konstatoi kryerjen e veprimeve konkrete dhe kohën e kryerjes, subjekti arsyetoi se veprimet janë kryer në datën 4.7.2006, në tejkallim të afatit 10-vjeçar të ushtrimit të ndjekjes penale.

⁷ “Shpërdorimi i detyrës”: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

⁸ Neni 66, “Parashkrimi i ndjekjes penale”: “Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: a) njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë; b) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim; c) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë; ç) tre vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim; d) dy vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë”.

⁹ Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.

9.4.v. Mbi këtë analizë, subjekti konkludoi se në bazë të germës “d” të pikës 1 të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, pavarësisht se këta persona¹⁰ kanë konsumuar elementet e veprave penale të “falsifikimit të dokumenteve” dhe të “shpërdorimit të detyrës”, ndaj tyre nuk mund të ushtrohet ndjekja penale, për shkak të parashkrimit. Subjekti kërkoi pushimin e hetimeve të procedimit penal të rifilluar në datën 13.4.2018. Në datën 18.4.2019, i njoftoi kallëzuesit dhe palët e tjera me kërkesën për pushimin e çështjes.

9.4.vi. Kërkesa e subjektit për pushimin e çështjes është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, Lezhë [e njëjta gjykatë që dha vendimin fillestar për plotësim të hetimeve mbi bazën e kërkesës së një prokurori tjetër], me vendimin nr. {***}, datë 5.6.2019. Kjo Gjykatë arsyetoi se kërkesa për pushim është rezultat i një hetimi të plotë e të gjithanshëm. Sipas vlerësimit të Gjykatës, organi i akuzës ka kryer hetime të mirëfillta në lidhje me detyrat e lëna më parë duke arritur në konkluzionin se të kallëzuarit kanë konsumuar figurat e veprave penale. Sipas Gjykatës, hetimet e kryera nga organi i akuzës, pas plotësimit të urdhëruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. {***}, datë 16.11.2016 [që lidheshin me hetimet e ndjekura nga një prokuror tjetër], duhet të pushohen për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Në konkluzion, Gjykata vlerësoi se nga ana e prokurorisë janë ndërmarrë veprime hetimore në zbatim të vendimit të gjykatës që i caktoi detyrat, pasi u hetua për secilin person përgjegjës dhe për veprimet konkrete të kryera prej tyre, duke përcaktuar edhe kohën kur u kryen veprimet.

9.5. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. {***}, datë 29.7.2019. Gjykata e Apelit Shkodër ka arsyetuar se shpërdorimi i detyrës¹¹, është kryer në vitin 2006 dhe deri në momentin e dhënies së vendimit, ka kaluar afati 10-vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale, prandaj prokuroria me të drejtë ka kërkuar pushimin e procedimit. Sipas Gjykatës, hetimet e organit të akuzës kanë qenë të plota dhe kur ndjekja penale për personin nën hetim është parashkruar, kallëzuesi duhet të realizojë interesat e tij të ligjshme nëpërmjet gjykimit civil. Pretendimet e ngritura në kallëzim, se veprimet e paligjshme të këtyre personave vijnë edhe në kohën kur merret vendimi, Gjykata i konsideroi të pabazuara në ndonjë provë apo akt shkresor të administruar në fashikullin e hetimit.

9.6. Mbi bazën e analizës së mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i Komisioneres Publike se *nuk u hetuan veprime pas vitit 2006*, bie ndesh me aktet dhe me dinamikën e veprimeve të konstatuara nga gjykata. Konkretisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka konkluduar se organi i akuzës ka verifikuar të gjithë veprimet konkrete dhe kohën e kryerjes së tyre. Duke pasur parasysh kohën e kryerjes së veprimeve, gjykata ka arritur në konkluzionin se ndjekja penale është parashkruar, pasi veprimi i fundit është i datës 19.10.2006 [kur u regjistrua certifikata e pronësisë]. Gjykata pranon se janë kryer një sërë veprimesh që në momentin që është depozituar kallëzimi penal dhe nuk ishte parashkruar ndjekja e tyre, *por afati i parashkrimit është plotësuar gjatë kohës që çështja ishte nën hetim*. Pra, duket se, orientimi që ka dhënë fillimisht

¹⁰ Subjekti konsideroi se kanë konsumuar elementet e veprës penale: Gj. K. (që ka qenë caktuar për të bërë matjet dhe caktimin e kufijve të kësaj prone); T. P. (Regjistruar në ZVRPP Lezhë); N. T. ; M. R. (kryeplaku i fshatit B. M. në vitin 2003) ka lëshuar një vërtetim (AMTP) që mban nr. {***}, datë 24.02.2003, dhe Sh. G. (përgjegjësi i ZAMT).

¹¹ Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.

grykata kishte për fokus konstatimin e veprimit të falsifikimit dhe të shpërdorimit të detyrës për hetime të kryera nga një prokuror tjetër, ndryshe nga sa pretendon Komisionerja Publike se nga akuza duhet të ishin kryer hetime edhe tej këtij afati.

9.7. Trupi grykues i Kolegjit thekson se, sikurse ka arsyetuar grykata, kryerja e mëtejshme e veprimeve me aktin e konstatuar si të falsifikuar më vonë, i përket natyrës civile të zgjidhjes së çështjes. Marrëdhënia e shitjes midis pronarit të paligjshëm dhe palëve të treta, rregullohet nga dispozitat e sferës civile¹², dhe nga palët e interesuara mund të kërkohet që grykata të rregullojë pasojat pas konstatimit të pavlefshmërisë së AMTP-së së vitit 2003. Në këtë konkluzion, trupi grykues i Kolegjit mban në konsideratë edhe faktin që për këtë çështje nuk ishte paraqitur ndonjë kallëzim dhe as vetë pala e interesuar, kallëzuesi/denoncuesi, nuk ka paraqitur kërkesë pranë Prokurorisë, por ka kërkuar konstatimin e falsifikimit dhe të shpërdorimit të detyrës. Për të vijuar më tej, marrëdhënia e shitjes kryer midis personave që nuk mbajnë detyra shtetërore, nuk ka vend që të trajtohet si “shpërdorim detyre”, ndërsa kryerja e falsifikimit është bërë në datën e krijimit të AMTP-së në vitin 2003, dhe regjistrimi i saj në vitin 2006, pra në tejkalim të afatit parashkruar të ndjekjes penale, ndërsa nuk konstatohen të jenë kryer veprime pas vitit 2006.

9.8. Për sa më lart, trupi grykues çmon se pretendimet e Komisioneres Publike janë të pabazuara. Subjekti i ka zbatuar urdhërimet e grykatës për hetim të detajuar rreth përdorimit të dokumenteve të falsifikuara pas qershorit të vitit 2006, kur rezulton se këto dokumente janë përdorur në kontrata shitblerje apo/dhe pranë institucioneve bankare, më së paku në vitin 2008, duke sjellë pasoja dhe përfitime për palët e tjera të përfshira. Pyetjet rreth çmimit të shitblerjes, kanë marrë përgjigje nga Grykata e Shkallës së Parë Lezhë me vendimin nr. {***}, datë 5.6.2019, dhe nga Grykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. {***}, datë 29.7.2019. Me këto vendime grykatat kanë konsideruar se subjekti ka zbatuar urdhërimet e grykatës dhe se hetimet e kryera prej tij ishin të plota dhe gjithëpërfshirëse, duke përjashtuar nevojën e kryerjes së hetimeve përtej vitit 2006. Nga aktet në dosje konstatohet se veprimet e kryera nga personat e kallëzuar janë maksimalisht në vitin 2006, kur u regjistrua certifikata, ndërsa pas kësaj date konstatohet se veprimet janë kryer nga persona të tretë, që dalin jashtë kallëzimit.

9.9. Nga ana tjetër, Kolegji kontrollon edhe faqen zyrtare të Grykatës së Lartë, me fokus këtë çështje. Nga ky burim i hapur rezulton se me vendimin nr. {***}/2024¹³, Grykata e Lartë, ka

¹² Referuar institutit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme [Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore].

¹³ 18. [...] prej datës së kryerjes së veprës penale, e identifikuar si e tillë, nga aktet e hetimeve paraprake nga të dyja grykatat, maksimalisht viti 2006 dhe deri në kohën e dhënies së vendimit objekt rekursi apo deri më sot, ka kaluar afati 10-vjeçar për ushtrimin e ndjekjes penale i kërkuar nga neni 66, pika “c” e Kodit Penal. Për rrjedhojë, çështja penale klasifikohet në ato lloj procedimesh për të cilat, sipas nenit 328-1/d të KPP, ekzistojnë shkaqe për të cilat ndjekja penale nuk mund të vazhdojë, si ai i referuar nga neni 66-1/c i Kodit Penal, sanksionuar me pasojë pushimin e çështjes penale. [...] 20. Në rastin konkret, vepra penale “Shpërdorimi i detyrës”, bazuar në nenin 248 të Kodit Penal, dënohet me burgim deri në shtatë vjet. Ndërsa vepra penale “Falsifikimi i dokumenteve”, bazuar në nenin 186/3, dënohet në maksimum me 7 vjet burgim. Nga interpretimi i nenit 66, pika “c” e Kodit Penal rezulton se, për të dyja këto vepra penale, ndjekja penale parashkruhet me plotësimin e afatit 10-vjeçar. [...] 21. Së fundi, pretendimet e ringritura në rekurs nga ana e kërkuarit N. K. lidhur me plotësimin e hetimeve paraprake apo se veprimet e paligjshme të personave të kallëzuar vazhdojnë, kanë marrë përgjigje të argumentuar nga grykata e apelit, sipas së cilës: “Grykata e Apelit i konsideron shkaqet e ankimit të ngritura nga kallëzuesi N. K. si të pabazuara (i cili sërish përsërit të gjithë faktin penal) pasi në kushtet kur veprimet hetimore janë të plota dhe kur ndjekja penale për personat nën hetim është parashkruar, kallëzuesi duhet të realizojë interesat e tij të ligjshme nëpërmjet një grykimi civil.

vendosur mospranimin e rekursit të kallëzuesit, për çështjen objekt shqyrtimi. Në linjë me konstatimin e subjektit, kjo Gjykatë, ndër të tjera ka arsyetuar se ka kaluar afati 10-vjeçar i kërkuar nga germa “c” e nenit 66 të Kodit Penal për ushtrimin e ndjekjes penale dhe se pretendimet e ngritura në rekurs kanë marrë përgjigje nga Gjykata e Apelit, duke bërë që çështja të marrë formën e gjësë së gjykuar.

9.10. Për sa më lart, në kuadër të kontrollit të aspektit të njohurive ligjore të subjektit dhe të pretendimit të Komisioneres Publike për moskryerje logjikisht të hetimit e për mosmbledhjen e provave sipas kërkesave të ligjit dhe orientimeve të gjykatës, dhe mungesë të analizës dhe argumentit logjik, trupi gjykues mbajti në konsideratë se në të gjitha shkallët e gjykimit, hetimet e subjektit u gjetën të plota dhe kërkesa për pushim u konsiderua e drejtë. Për këtë arsye, pretendimi për këtë aspekt nuk u pranua.

9.11. Komisionerja Publike pretendon, gjithashtu, se subjekti nuk dha shpjegime bindëse mbi mungesën e konkretizimit dhe saktësisht të veprimeve hetimore në urdhrin e nxjerrë prej tij, si dhe për mungesën e mbikëqyrjes së veprimeve të Oficerit të Policisë Gjyqësore.

9.11.i. Nga aktet në dosje, evidentohet se në datën 27.4.2018, pas regjistrimit të çështjes, subjekti ka urdhëruar Oficerin e Policisë Gjyqësore të që kryejë të gjithë veprimet hetimore të lëna si detyrë nga gjykata dhe të relatojë mbi ecurinë e çështjes, referuar urdhërimit të gjykatës në vendimin nr. {***}, datë 16.11.2016. Subjekti ka udhëzuar edhe që të relatohet mbi ecurinë e çështjes, në varësi të rezultatit të hetimeve. Së fundmi, subjekti ka kërkuar që OPGj-ja (i njëjti që ka qenë caktuar në hetimin e çështjes më parë), të relatojë edhe për mënyrën e përfundimit të hetimeve deri në datën 30.6.2018.

9.11.ii. Nëpërmjet një akti konstatimi të datës 10.10.2018, subjekti i rivlerësimit ka konstatuar se nuk ishin kryer veprime hetimore sipas urdhrin të tij të datës 27.4.2018, dhe pas analizimit të situatës dhe diskutimit me OPGj-në, i cili ishte i të njëjtit mendim si në qëndrimin e tij fillestar, pra atë të pushimit të procedimi. Në këtë akt, subjekti ka shtuar se edhe kallëzuesi ka kërkuar ndryshimin e OPGj-së. Pas aktit të konstatimit, subjekti i ka paraqitur drejtuesit të Prokurorisë kërkesën për zëvendësimin e OPGj-së së çështjes. Kjo kërkesë u pranua me vendim nga Drejtuesi i Prokurorisë Lezhë, dhe në datën 22.10.2018, u krye zëvendësimi i OPGj-së¹⁴.

9.11.iii. Në përgjigje të barrës së provës në Komision, subjekti ka shpjeguar se oficerit [OPGj-së të cilit i ishte ngarkuar çështja] i ishte lënë një afat për kryerjen e veprimeve. Për shkak të volumit të punës, për më tepër në seksionin ku përfshihej dhe dispozita penale konkrete, policisë gjyqësore i është lënë gjithmonë një afat shtesë verbalisht, i paurdhëruar formalisht. Pas vlerësimit të akteve dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni nuk gjeti problematikë të rastit, as në këtë drejtim.

9.12. Në përgjigje të pretendimeve në ankim, pavarësisht se subjekti në urdhër nuk ka shënuar më mënyrë specifike se cilat do të ishin detyrat që duhet të zbatonte Oficeri i Policisë Gjyqësore, përpos referimit në vendimin e gjykatës që la për zbatim detyrat përkatëse, pas konstatimit të

Pretendimet e tij të ngritura në kallëzim se veprimet e paligjshme të këtyre personave vazhdojnë edhe sot, konsiderohen të pabazuara në ndonjë provë apo akt shkresor të administruar në fashikullin e hetimit”.

¹⁴ Neni 33, “Varësia funksionale e policisë gjyqësore”: “1. Policia gjyqësore përgjigjet përpara prokurorit për veprimtarinë e kryer prej saj gjatë procedimit penal. 2. Policia gjyqësore kryen detyrat që i janë caktuar nga prokurori dhe e njofton atë menjëherë mbi rezultatet e tyre [...]”.

mungesës së kryerjes së veprimeve, trupi gjykues i Kolegjit mbajti në vëmendje se subjekti ka ushtruar kontroll dhe ka kërkuar nga Drejtuesi i Prokurorisë zëvendësimin e OPGj-së së çështjes.

9.13. Nga ana tjetër, duke qenë se subjekti nuk kishte shënuar emrin e ndonjë prej personave që i atribuohet vepra penale në regjistër, afati i hetimeve në këtë rast ndjek afatin e caktuar në nenin 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale, që domethënë, tre muaj nga momenti që i shënohet emri në regjistër personit, por në çdo rast jo më shumë se dy vjet kur nuk ka të shënuar emrin, në fazë të hetimeve paraprake. Në këtë mënyrë, nuk mund të konkludohet se veprimet e subjektit kanë cenuar të drejta të palës së interesuar, pavarësisht se kontrolli i ushtruar nga OPGj-së ka qenë i vonuar [pas dy muajsh nga data e shënuar për raportim]. Me konsideratë vendimin nr. 6/2024, të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit është përgjegjësia e prokurorit që të udhëheqë hetimet dhe e policisë gjyqësore në drejtim të zbulimit të autorit të veprës penale, kontrolli ndaj OPGj-së, nuk ka qenë me rëndësi vendimtare për zgjidhjen e çështjes dhe respektimin e afateve.

9.14. Trupi gjykues i Kolegjit, thekson se si për këtë çështje, ashtu edhe për raste të tjera në vijim, është evidentuar se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes sipas kërkesës së Prokurorisë/subjektit. Në rastin konkret, pavarësisht se ndjekja e veprës penale është parashkruar, subjekti është investuar dhe ka kryer hetime gjithëpërfshirëse duke përcaktuar personat përgjegjës dhe veprën penale të konsumuar. Për këto arsye, mangësitë e evidentuara u vlerësuan nga trupi gjykues se janë të tilla që nuk cenojnë elementet e neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, për aftësitë profesionale të subjektit.

10. Denoncimi i z. E. K. që lidhet me procedimin penal nr. {***}/2018:

10.1. Komisionerja Publike pretendon në ankim se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, pasi ka përcjellë çështjen për pushim, pa ia nënshtruar atë një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimit të drejtë të ligjit, që do të lejonte në përcaktimin e fajësisë dhe zbardhjen e plotë të mekanizmit të ngjarjes dhe rolit të funksionarëve të shtetit. Pushimi i çështjes, pa kryer hetime të plota me objekt kallëzimi veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumenteve, vë në dyshim thelbin e vendimmarrjes së prokurorit për akuzat e personave të përfshirë – funksionarë shteti, duke afektuar nënindikatorin e parashikuar nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

10.2. Denoncuesi ka paraqitur në Komision një ankesë ndaj kërkesës së subjektit të rivlerësimit të datës 6.9.2019, për pushimin e çështjes penale ndaj z. P. P., me arsyetimin se është parashkruar ndjekja penale. Denoncuesi parashtron se është pronar i një sipërfaqeje prej 8.800 m² tokë ndodhur në {***}, Lezhë, e trashëguar dhe e marrë me ligjin nr. 7501/1991, nëpërmjet AMTP-së nr. {***}, të vitit 1993. Nga ana tjetër, sipas denoncuesit, një sipërfaqe prej 5.566 m² i është pushtuar në mënyrë abuzive nga i kallëzuar. Sipas denoncuesit, personi që i pushtoi tokën ka qenë banor i fshatit {***} Lezhë para gushtit 1991 me (4 frymë) dhe rezultoi i pajisur me tokë më tepër se ç'lejonte ligji (gjithsej 17.090 m² dhe 14.625 m²). Denoncuesi pretendon se pushtuesi i paligjshëm ka falsifikuar AMTP, duke rezultuar me 17.000 m² tokë të përfituar sipas ligjit nr. 7501 në vend të 15.000 m². Denoncuesi ka paraqitur kallëzim penal në prokurori për *pushtim të paligjshëm* të tokës, *përvetësim të paligjshëm të pasurisë publike* dhe *falsifikimit të dokumenteve zyrtare*, ndaj z. P. P. Denoncuesi pretendon se vendimi i datës 6.9.2019, i subjektit të rivlerësimit është “absurd” pasi ai [subjekti] i ka kërkuar Gjykatës *pushimin e procedimit penal nr. {***}, viti 2018*, për veprat

penale të “falsifikimit të dokumenteve” dhe të “shpërdorimit të detyrës”, të parashikuara nga nenet 185/1 dhe 248 të Kodit Penal. Denoncuesi citon dy vendime gjyqësore¹⁵ me të cilat i është dhënë pjesërisht e drejta, në lidhje me pushtimin e 2.200 m² tokë nga kufitari P. P. (vendimi i pazbatuar dhe i ankimuar nga pushtuesi i tokës), dhe në lidhje me pushtimin e 3.325,9 m² tokë (vendim i ankimuar), por që janë të administruara dhe bërë pjesë e hetimit nga subjekti. Ai pretendon edhe se materialet janë falsifikuar në bashkëpunim me subjektin e rivlerësimit dhe që raporti i ekspertimit datë 6.5.2019¹⁶, nuk ndodhet në dosjen penale.

10.3. Nga fashikulli i dërguar në Komision nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për procedimin penal {***}, të vitit 2018, denoncuesi ka paraqitur kallëzim penal në datën 21.3.2018, ndaj z. P. P., për marrje të padrejtë/pushtim të sipërfaqes së tokës së tij prej 2.200 m² në fshatin {***} Lezhë nëpërmjet një AMTP-je që i është dhënë në mënyrë të kundërligjshme nga zyrtarët e kohës. Në datën 12.11.2018, denoncuesi ka paraqitur edhe një informacion në Prokurorinë për Krimet e Rënda për të kryer verifikim pranë ZVRPP Lezhë para se të bëhen ndryshime në kartelën e pronësisë së pasurisë objekt shqyrtimi.

10.3.i. Pas regjistrimit të procedimit penal në fjalë, subjekti mori në pyetje (i) kallëzuesin dhe të kallëzuarin; (ii) Kryetarin e Komisionit të Ndarjes së Tokës në Fshatin {***} Lezhë (që kishte lëshuar AMTP-në, i cili pranoi se ishte bërë një gabim pasi AMTP-ja e re duhej lëshuar me fraksion); (iii) Kryeplakun e këtij fshati (nënshkrimi i të cilit nuk ishte në AMTP-në pa datën e të kallëzuarit); (iv) administroi praktikat nga Njësia Administrative Shëngjin Lezhë, nga Zyra e Gjendjes Civile Shëngjin; (v) nga Drejtoria e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Lezhë; (vi) nga ZVRPP Lezhë dhe (vii) bëri pjesë të fashikullit vendimin nr. {***}/2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë (që konstatoi posedimin në keqbesim të 2.200 m² nga i kallëzuari) dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër nr. {***}/2015 (që prishi vendimin e shkallës së parë për mosformim të drejtë të ndërgjyqësisë); urdhëroi edhe kryerjen e aktit të ekspertimit (pasi administrohen dy AMTP me sipërfaqe të ndryshme, pa data dhe me kryetarë të ndryshëm).

10.3.ii. Gjatë kohës që çështja ishte në proces hetimi, ZVRPP-ja Lezhë ka proceduar administrativisht me korrigjimet për përmirësimin e bllokut kadastral (për shkak të mbivendosjeve) dhe sipërfaqja e pasurisë së denoncuesit nuk rezultoi më e zënë nga z. P. P. Pasi u informua rreth këtij fakti, nëpërmjet akteve që vuri në dispozicion ALUIZNI Lezhë në datën 29.3.2019, subjekti arsyetoi se nisur nga gjendja në atë kohë e bllokut të pasurisë, pas korrigjimeve të kryera, nuk ekzistonte rrethana e pushtimit të tokës, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, dhe në datën 3.9.2019, subjekti vendosi të pushojë pjesërisht hetimet për veprën penale të “pushtimit të tokës”, për të cilën ishte shënuar në regjistër emri i z. P. P. Ndaj këtij vendimi, denoncuesi nuk ushtroi ankim.

¹⁵ Bashkëlidhur denoncimit, janë vendimet nr. {***}, datë 6.1.2014 dhe vendimi nr. {***}- 2019 të Gjykatës Lezhë.

¹⁶ Ky akt duket se është administruar nga subjekti, pasi ai e referon në kërkesën e vitit 2019 për pushimin e çështjes: “duke marrë në konsideratë dhe aktin e ekspertimit, ku konkluzione janë të njëjta me një akt të mëparshëm” dhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, të datës 15.2.2022, në faqen 13, paragrafi i dytë. Në këtë kuptim, pretendimi i denoncuesit se subjekti e fshehu këtë akt, nuk qëndron.

10.3.iii. Më datë 6.9.2019, në bazë të germës “d”¹⁷ të pikës 1 të nenit 328 dhe të nenit 329/a¹⁸ të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka dërguar në Gjykatë “Kërkesën për pushimin e hetimeve” për veprat penale të parashikuara nga nenet 186/1 dhe 248 të Kodit Penal, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, sipas nenit 66/1/c¹⁹ të Kodit Penal. Subjekti arsyetoi se për veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga nenit 186/1²⁰ i Kodit Penal, duhet të pushohet pasi nuk u arrit të provohej se cili ka qenë autori dhe se ka kaluar më shumë se 5 vjet, pavarësisht se ajo rezulton e konsumuar. Për rrjedhojë, afati i ndjekjes 10 vjet nga koha e kryerjes së veprës, ka kaluar. Ndërsa për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, subjekti arsyetoi se ndodhemi përpara konsumimit të veprës penale, por nuk mund të provohet se kush e depozitoi AMTP-në në ZVRPP. Ai konstatoi se përfituesi është z. P. P., ndërkohë që regjistrimi më i hershëm, sipas subjektit, ishte bërë në vitin 2004. Me të njëjtën logjikë, atë të parashkrimit të ndjekjes nga koha e kryerjes së veprimeve nga funksionarët publik, duke konsideruar vitin 2004 momentin e fundit të kryerjes së veprimeve, subjekti kërkoi pushimin edhe për veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

10.3.iv. Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, me vendimin nr. {***}, datë 22.7.2020, e rrëzoi kërkesën e subjektit për pushim dhe ia ktheu aktet për të vijuar hetimet për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, ndërsa la në fuqi vendimin për pushimin e pjesshëm të hetimeve për veprën penale të “pushtimit të tokës”. Kjo gjykatë arsyetoi se kërkesa për pushimin e çështjes nuk është rrjedhojë e një hetimi të plotë. Në vlerësim të Gjykatës, prokuroria duhet të kryente të gjithë veprimet e mundshme hetimore për të provuar ekzistencën e faktit penal dhe autorin e veprës penale dhe vetëm pas këtij momenti mund të analizojë nëse ka shkaqe padënueshmërie. Gjykata vlerësoi se interpretimi se nuk *u arrit të provohej se cili është autori i falsifikimit*, është interpretim i gabuar i nenit 186/1 të Kodit Penal. Sipas Gjykatës, problemi ligjor që shtrohet për zgjidhje është nëse i kallëzuari kishte dijeni se AMTP-ja ka qenë e falsifikuar, duke qenë se kjo është vepër penale që kryhet me dashje. Gjykata konkludoi se prokuroria duhet të hetojë për këtë fakt dhe për qëllimin e këtij veprimi për të cilin vetëm P. P. kishte interes. Gjykata ka vlerësuar gjithashtu edhe se, pavarësisht konstatimit të veprës penale, nga ana e prokurorisë nuk janë shtrirë hetimet për elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës nga punonjësit e administratës shtetërore. Gjykata e Shkallës së Parë, urdhëroi prokurorinë që të kryejë hetimet e nevojshme, dhe pas këtyre veprimeve, të argumentojë hollësisht nëse ka shkelje të kryer nga z. P. P. apo nga punonjës shtetërorë apo institucione shtetërore që e kanë lëshuar, administruar apo regjistruar AMTP-në.

10.3.v. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Apelit Shkodër. Subjekti argumentoi se janë kryer të gjithë veprimet hetimore që ka specifikuar shkalla e parë në vendim dhe shpjegoi procedurën e ndjekur dhe konkluzionet e arritura. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 6.11.2020, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

¹⁷ d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;

¹⁸ 1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.

¹⁹ Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: c) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim; ç) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë; [...].

²⁰ Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet.

Lezhë nr. {***}, datë 22.7.2020, me arsyetimin se shkaqet e ngritura në ankim çojnë në konkluzionin se vendimi i shkallës parë është i bazuar plotësisht në ligj dhe në prova. Kjo gjykatë arsyetoi se ankuesi/subjekti i rivlerësimit nuk ka parashtruar se përse vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i bazuar, por thjesht ka përmendur të gjithë provat e marra gjatë hetimit. Gjykata arsyeton edhe se: *“megjithëse është e pamundur në fakt të përcaktohet se kush është personi përgjegjës që e ka prodhuar dhe falsifikuar këtë akt AMTP-në pa datë, mund të vërtetohet lehtësisht se kush e ka përdorur dhe përfituar të drejta pronësie prej saj, që është z. P. P.”*. Gjykata arsyetoi se organi i akuzës duhet të konkludojë nëse ky individ, me dashje dhe me dijeni, ka përdorur dokument të falsifikuar duke përfituar të drejta pronësie prej tij, si dhe të identifikojë kohën e përdorimit të aktit të falsifikuar. Ndërsa për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, kjo gjykatë e gjeti të drejtë konkluzionin e organit të akuzës referuar hetimeve të kryer, nga i cili rezulton se momenti i fundit i përdorimit të aktit është viti 2004, kur është kryer regjistrimi, çka çon në parashkrim të ndjekjes penale. Sipas gjykatës, kryerja e hetimeve të mëtejshme, për sa kohë nuk mund të konkludohet me dërgim në gjyq apo dënim të personave fajtorë, do të ishte e panevojshme, pasi ndjekja është parashkruar. Shkaqet e ngritura në ankim, janë të pabazuara pasi hetimet janë të paplota në drejtim të faktit penal parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal – falsifikimi i dokumenteve. Pra, Gjykata e Apelit, pavarësisht se e gjeti të drejtë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, lidhur me mungesën e hetimeve, analizoi se nevoja për hetim duhet të orientohet drejt veprës penale të “falsifikimit të dokumenteve” dhe jo atë të “shpërdorimit të detyrës” siç arsyetoi gjykata e shkallës së parë. Pas plotësimit të hetimit, subjekti paraqiti përsëri kërkesën për pushimin e çështjes.

10.3.vi. Për një panoramë të plotë të vendimmarrjes pas hetimeve, nga aktet në fashikull [vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë] rezulton se gjykata shprehet se: *“në varësi të detyrave të lëna nga Gjykata, janë kryer veprimet hetimore”*. Pra, organi i akuzës kreu hetimet nga momenti që u dërgua çështja nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 6.11.2020. Në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë nr. {***}/2022, që shqyrtoi rastin për herë të dytë dhe pasi subjekti ishte transferuar në Tiranë, ndër të tjera, pasqyrohet se nga organi i akuzës u evidentua se i kallëzuari ka qenë personi që ka përfituar nga paraqitja për regjistrim e AMTP-së pa datë, e cila është lëshuar dhe nënshkruar qoftë nga kryetari i Komisionit të Ndarjes së Tokës në fshatin {***} Shëngjin, dhe i kallëzuari tjetër. Gjykata referon se akuza arsyetoi se: *cilado qoftë situata, nuk mund të provohet se z. P. P. të ketë dijeni se vula e Këshillit të Qarkut në atë AMTP, të jetë e falsifikuar*. Ndërsa duket se prokurori i çështjes, ndër të tjera, ka konstatuar që dy funksionarët e përmendur kanë konsumuar elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, pasi pajisën një person me më tepër tokë sesa i takonte, nga ligji nr. 7501/1991 *“Për tokën”*. Sipas përmbajtjes së vendimit nr. {***}/2022, nga koha e përdorimit të AMTP-së pa datë/të falsifikuar, 12.5.2000, kanë kaluar 20 vjet dhe është parashkruar e drejta e ushtrimit të ndjekjes penale. Në këtë mënyrë, nga organi i akuzës është ridërguar në gjykatë kërkesa e dytë për pushim hetimi²¹. Kjo kërkesë (1) është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. {***}, datë 15.2.2022, duke vendosur: (2) pushimin e hetimeve për kryerjen e veprave penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuara nga nenet 186/1/2 e 248 të Kodit Penal; (3)

²¹ Nuk administrohet me aktet e dosjes, por citohet në vendimin e gjykatës që e shqyrtoi.

deklarimin e falsitetit të dokumentit AMTP me nr. {***}, pa datë, lëshuar në emër të z. P. P. dhe (4) fshirjen e regjistrimeve dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

10.3.vii. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 17.6.2022, duke e kthyer për rigjykim pranë Gjykatës e Shkallës së Parë Lezhë. Gjykata e Apelit ka arsyetuar se vendimi i shkallës së parë për pranimin e kërkesës për pushim është i drejtë dhe palët nuk kanë paraqitur ankim për kërkesën për pushimin e hetimeve, por vetëm për pikës 3 dhe 4 të dispozitivit [*që lidhej me: (3) deklarimin e falsitetit të dokumentit AMTP me nr. {***}, pa datë, lëshuar në emër të z. P. P., dhe (4) fshirjen e regjistrimeve dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme*].

10.3.viii. Nga ana tjetër, gjykata e Apelit arsyeton se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është kontradiktor, dhe se AMTP-ja pa datë, e cila ka shtuar sipërfaqen e pronësisë për të kallëzuarin në kundërshtim me ligjin dhe është nënshkruar nga njëri prej zyrtarëve të kohës, është akt pjesërisht i parregullt dhe i nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 7501 “Për tokën”, por jo tërësisht të pavlefshëm. Gjithashtu, konstatoi se Gjykata e Shkallës së Parë, Lezhë ka tejkaluar kërkimet e organit të akuzës, duke vendosur sipas pikave 3 dhe 4, si dhe i mungon arsyetimi për shkak se nuk ka të dhëna për z. P. P. Kjo gjykatë ka administruar edhe vendimet civile, nga të cila rezultoi se me vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër nr. {***}, datë 21.1.2022²², është vendosur lënia në fuqi e vendimit që detyroi z. P. P. që të lirojë dhe dorëzojë sipërfaqen që posedon prej 3.328,9 m². Gjykata e Apelit konstatoi mungesë të arsyetimit të vendimit dhe keqformim të ndërgjyqësisë [pjesëmarrja e z. E. K., pasi ligji procedural nuk parashikon pjesëmarrjen e kallëzuesit në gjykim në rastet e pushimit të hetimit, por vetëm të viktimës së veprës penale²³]. Pas kthimit të çështjes për rigjykim, dhe pas transferimit të subjektit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 1.11.2022, Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë dhe pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***} të vitit 2018, për veprat penale të parashikuara nga nenet 186/1/2 dhe 248 të Kodit Penal.

10.4. Komisioni konkludoi në vendim, se për këtë çështje nuk u konstatuan problematika për subjektin e rivlerësimit dhe që në vitin 2022, Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë ka pranuar përfundimisht kërkesën e subjektit për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}/2018.

10.5. Trupi gjykues i Kolegjit vëren së pretendimi i Komisioneres Publike se subjekti nuk ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, nuk qëndron. Nga analiza e akteve në fashikuj, nuk rezulton që veprimet e subjektit të pasqyrojnë arsyetime të gabuara, paftësi për të ndërmarrë hetimin, mungesë hetimesh apo zvarritje që kanë dëmtuar interesat e palëve. Veprimet hetimore që rezultojnë nga aktet në fashikull dhe shpjegimet në proces, tregojnë që subjekti ka kryer hetime të gjithanshme për të zbardhur dinamikën e ngjarjeve, administruar akte, pyetur personat që kishin dijeni, dhe sipas rastit, disponuar e administruar edhe aktekspertime për të qartësuar nëse pretendimet e kallëzuesit provonin rrethanat që pretendonin vepër penale. Pavarësisht se çështja u kthye për plotësim të hetimeve, ky fakt nuk pati asnjë ndikim në zgjidhjen e saj, pasi rezultati final ishte pranimi i kërkesës për pushim, në një linjë me arsyetimin e subjektit. Nga sa rezulton më lart,

²² Në vitin 2022, pasi subjekti ishte larguar nga Prokuroria Lezhë, çështja është ndjekur nga një prokuror tjetër, i cili po ashtu ka kërkuar pushimin e hetimeve për të dy veprat penale.

²³ Denoncuesi e kishte këtë cilësi, në rastin e pushtimit të tokës, ndërsa kjo vepër u pushua, pasi palët shkuan në gjendjen e mëparshme për efekt të akteve administrative.

subjekti ka kryer hetime të gjithanshme për të zbardhur dinamikën e ngjarjeve, ka administruar akte, ka pyetur personat që kishin dijen, paçka se në krye të herës ishte evidente që ndjekja penale ishte parashkruar.

10.6. Ndërsa, për pretendimet e Komisioneres Publike që lidhen me qasjen e subjektit ndaj funksionarëve të shtetit, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje se subjekti ka konstatuar përgjegjësinë penale të Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës në Fshat, që kishte kompetencë të lëshonte/nënshkruante AMTP-të. Me kërkesën për pushimin e hetimeve, u pajtua edhe gjykata e apelit, që e ktheu çështjen për hetime të veprës penale të falsifikimit nga z. P. P. dhe jo funksionarëve publikë, ndryshe nga shkalla e parë që kërkoi hetime të thelluara për shpërdorimin e detyrës, Gjykata e Apelit çmoi se është e panevojshme për sa kohë është parashkruar ndjekja penale. Për këto arsye, edhe ky pretendim nuk qëndron.

11. Denoncimi i z. G. C. që lidhet me procedimin penal nr. {*}/2019:**

11.1. Komisionerja Publike pretendon se për çështjet penale që lidhen me falsifikimin e dokumenteve dhe shpërdorimin e detyrës, në tjetërsimin e pronave, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar vëmendje maksimale duke qenë proaktiv në përdorimin e të gjitha mjeteve ligjore, për efekt të perceptimit të publikut për seriozitet maksimal ndaj akuzave për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh. Pretendimet e denoncuesit gjejnë mbështetje në aktet në dosje. Akti i ekspertimit tekniko-grafik, ka evidentuar se dokumentacioni i pajisjes me tokë në emër të A. Ll. B. dhe Gj. D. B., është i falsifikuar. Ndërkohë, nga ekspertimi topografik ka rezultuar se sipërfaqet e përfituara me dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Lezhë janë ranishte dhe jo tokë bujqësore (arë). Ky akt ekspertimi mban datën 5.2.2020, ndërsa vendimi i subjektit për transferimin e dosjes mban datën 19.9.2021. Rastet e neglizhencës dhe zvarritjet shfaqin sjellje që nuk ngjallin besim te sistemi i drejtësisë drejt përcaktimit në kohë të përgjegjësisë të personave të përfshirë, pasi rezulton se, në të gjitha këto raste subjekti i rivlerësimit ka vendosur të mos regjistrojë emrat e personave në regjistrat e veprës penale dhe të zgjasë hetimet përtej afateve të lejuara, rrethana që prekin indikatorët e përcaktuar nga neni 73/2/3²⁴ i ligjit nr. 96/2016.

11.2. Denoncuesi ka parashtruar në Komision [dhe në Kolegji] se për kallëzimin e datës 7.8.2019, të regjistruar në datën 19.09.2019, prokuroria nuk është përpjekur të bëjë hetim të thelluar për të zbuluar dhe dokumentuar ekzistencën e një grupi të strukturuar kriminal, i cili, në marrëveshje midis tyre, kanë falsifikuar dokumente zyrtare, shpërdoruar detyrën dhe tjetërsuar pronat e tij. Sipas deklarimeve në denoncim, parcelat shtetërore “ranishte” në zonën e plazhit të quajtur “{***}”, në Njësinë administrative Shëngjin, janë tjetërsuar në kundërshtim me ligjin. Denoncuesi pretendon se prej vitit 2005, ai dhe trashëgimtarët e tjerë të pronave në Lezhë, kanë bërë përpjekje për njohjen dhe kthimin e tokave të trashëguara. Zgjatja e paarsyeshme e hetimeve, sipas denoncuesit, ka ardhur për shkak se prokurori/subjekti i rivlerësimit është i paafte dhe i pamotivuar

²⁴ 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. 3. Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.

në kryerjen e detyrave, ose mund të jetë nënshtruar nga bota e krimit dhe njerëzve me pushtet, ose pret “oferta” nga pala e dëmtuar²⁵.

11.3. Në vendim, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë hetim penal në veprimet e subjektit. Komisioni evidentoi se në bazë të hetimit të tij dhe regjistrimit më pas të personave ndaj të cilëve ka filluar hetimi është bërë i mundur dërgimi dhe ndjekja e kësaj çështjeje penale pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim “SPAK”).

11.4. Nga përmbajtja e akteve dhe shpjegimet e subjektit evidentohet se kallëzimi penal është bërë në datën 7.8.2019, ndërsa regjistrimi në datën 19.9.2019, pra rreth një muaj e gjysmë më vonë, nëse nuk mbajmë në konsideratë këtu faktin se muaji gusht, kryesisht është periudhë pushimesh, si dhe mungesën e dokumentacionit. Në Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar²⁶, është parashikuar se afati maksimal brenda të cili prokurori mund të kryejë veprime të verifikimit të rasteve që nuk lejojnë mosfillimin e procedimit, pra të regjistrimit apo jo të procedimit, është 10 ditë, dhe maksimalisht, 30 ditë. Në mungesë të akteve, por në referim të datave të cituara nga denoncuesi dhe subjekti, duket se afati nga momenti i paraqitjes së kallëzimit deri në momentin e regjistrimit të procedimit, kanë kaluar 43 ditë. Ky afat e tejkalon me 13 ditë kohën brenda të cilës duhet të ishte bërë regjistrimi. Në dosje nuk ka akte që të evidentohet shorti se kur i kaloi subjektit, por gjithsesi tejkalimi me 13 ditë mbetet në kundërshtim me udhëzimin e sipërcituar të Prokurorit të Përgjithshëm për regjistrimin e procedimit.

11.5. Së dyti, sipas shpjegimeve të subjektit dhe informacionit nga përmbajtja e vendimit të administruar në fashikull, nga data 19.9.2019, që është data e regjistrimit të procedimit penal nr. {***}/2019, deri në datën kur subjekti mori vendimin për kalimin e akteve Prokurorisë së Posaçme, datë 19.2.2021, emri i personave që iu atribuohet vepra penale, u vendos nga subjekti të shënohej në momentin e shpalljes së moskompetencës, pas 17 muajsh hetime. Gjithashtu, akti i ekspertimit tekniko-grafik, që përcaktoi falsifikimet e personave përkatës, është i datës 5.2.2020. Nga kjo datë, përreth një vit, është dashur që subjekti të vendosë shpalljen e moskompetencës.

11.6. Neni 287 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon detyrimin e prokurorit që të shënojë në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. Subjekti ka shpjeguar se ky veprim është kryer me përfundimin e hetimeve, ndërkohë që normat procedurale nuk përmbajnë ndonjë detyrim të prokurorëve të shënimit të emrit të personit në regjistër kur nuk iu rezulton një i tillë,

²⁵ Nga përmbajtja e denoncimit, duket se subjekti i ka kthyer përgjigje kallëzuesit ku e ka informuar se afatet e hetimeve janë penguar nga gjendja e pandemisë.

²⁶ 2.1 Në rastet kur, me gjendjen e akteve prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, vendos mosfillimin e procedimit, por jo më vonë se 10 ditë nga mbërritja e kallëzimit apo referimit të veprës penale. Gjatë kësaj periudhe mund të bëhet një minimum verifikimesh nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt vendoset regjistrimi i procedimit. 2.2. Në raste të veçanta, kur me gjithë verifikimet e kryera në afatin e përcaktuar në pikën 2.1 të sipër përmendur, prokurori vlerëson se është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementëve thelbësorë të faktit dhe/ose të elementëve të figurës së veprës penale, afati i verifikimit, të kallëzimit penal dhe/ose njoftimit të veprës penale të marr me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 30 ditë. Gjatë periudhës 30-ditore, të parashikuar në pikën 2.2 të këtij Udhëzimi, prokurori, kryen vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Gjatë kësaj periudhe, prokurori, nuk kryen veprime hetimore nga ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

përpos respektimit të afateve të maksimale të hetimeve paraprahe deri në dy vjet në rastet kur nuk ka një person që i atribuohet vepra penale²⁷.

11.7. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë në shkresën përcjellëse ka theksuar se procedimi penal nr. {***}/2019, më datë 19.2.2021, është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në vendimin e subjektit janë përshkruar veprimet hetimore dhe është evidentuar se në Prokurorinë Lezhë është regjistruar procedimi penal nr. {***}/2019, mbi bazën e kallëzimit të z. A. C. [vëllai i denoncuesit]. Sipas vendimit të subjektit, kallëzimi penal lidhej me tjetërsimin në kundërshtim me ligjin të parcelave shtetërore që ishin “ranishte” përgjatë bregut të detit, si dhe në shpatoren e malit, në zonën e {***}, në Shëngjin.

11.8. Në vendimin e transferimit, subjekti ka evidentuar se gjatë vitit 2016, Bashkia Lezhë ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Lezhë dokumentacionin për pajisjen me tokë të z. A. Ll. B. dhe Gj. D. B. Praktikant e dokumentacionit të dërguara nga Bashkia Lezhë përmbajnë aktin e marrjes së tokës në pronësi, vërtetimet e kufizimeve, konfirmimet e pasurive, planet e rievimit si dhe certifikatën familjare të datës 1.8.1991. Pas administrimit të dokumentacionit, ZVRPP Lezhë ka konstatuar se sipërfaqet e pasurive nuk janë “tokë bujqësore”, por “ranishte”. Për këtë arsye, ky institucion ka kërkuar konfirmim për dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Lezhë duke ju drejtuar me shkresë përkatëse këtij institucioni [Bashkisë] dhe Këshillit të Qarkut Lezhë. Në përgjigje, këto institucione janë shprehur se pasuritë janë tokë “arë”. Në vijim, ZVRPP ka proceduar me regjistrimin e këtyre pasurive. Sipas akteve të ekspertimit tekniko-grafik të kryer si rezultat i veprimeve hetimore e që referohet nga subjekti në vendim, ka rezultuar se, dokumentacioni i pajisjes me tokë në emër të z. A. Ll. B. dhe Gj. D. B. është i falsifikuar dhe se, sipërfaqet objekt analize janë *ranishte*, ose parcela toke që shtrihen në brezin ranor të plazhit “{***}”. Përveçse ka referuar që janë falsifikuar aktet, pasi toka nuk është bujqësore, subjekti ka konstatuar po ashtu, se përfituesit e këtyre pronave nuk janë banorë të zonës, e për pasojë, nuk mund të përfitonin tokë në bazë të ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”. Për rrjedhojë, me dokumente të falsifikuara janë regjistruar pasuri që janë pyll, ranishte - vija e parë e bregut, shkurre, shkëmb, me pronar “shtetin”, dhe jo tokë bujqësore, që nuk mund të regjistrohen në zbatim të ligjit nr. 7501/1991.

11.9. Subjekti evidenton në vendim se pas hetimit, prokurori ka shënuar në kolonën përkatëse të regjistrimit të procedimeve penale për procedimin penal nr. {***}/2019, emrat e disa funksionarëve²⁸ dhe nëpunësve të administratës vendore dhe asaj qendrore në nivel vendor, si dhe shtetasit përfitues të dy pasurive, për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186/2 dhe 186/3 të Kodit Penal [ndërkohë që për përllogaritjen e afateve të hetimit paraprahe, nuk mund të saktësohet data për mungesë aktesh]. Referuar nenit 75/a, pika “c” të Kodit të Procedurës Penale, më datë 19.2.2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur, kalimin e akteve të procedimit penal nr. {***} viti 2019, për shkak të moskompetencës lëndore²⁹,

²⁷ 1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.

²⁸ Njëri prej tyre, F. F., ish-kryetar i Bashkisë Lezhë.

²⁹ Neni 75/a, pikat c e ç të K.Pr.Penale përcaktojnë se: “Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: c) Akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Anëtarit të këshillit të Ministrave, Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të

Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë.

11.10. Në vendimin mbi kalimin e akteve, subjekti ka përshkruar veprimet e kryera prej tij, ndërkohë që i vetmi veprim që konstatohet është akti i ekspertimit i datës 05.02.2020. Subjekti referon në vendim se u administrua dokumentacion në kuadër të procedimit, ka kërkuar informacion nga ZVRPP Lezhë, Këshilli i Qarkut Lezhë, Bashkia Lezhë dhe nga Komuna Shëngjin. Aktet që referon subjekti në këtë vendim, përmbajnë data të një kohe përpara regjistrimit të kallëzimit penal. Veprimet e regjistrimit dhe tjetërsimit të pasurive, janë kryesisht të vitit 2016 dhe 2017. Për veprimet hetimore, subjekti nuk ka shpjeguar nëse e konsideroi si një çështje të komplikuar, apo të ngarkesës në punë, në mënyrë që të justifikojë nevojën e kohështirjes së hetimeve gjatë 17 muajve.

11.11. Në rastin konkret nga momenti i regjistrimit, e deri në shpalljen e moskompetencës, kanë kaluar rreth 17 muaj, që nënkupton se nuk është tejkaluar afati 2-vjeçar. Për rrjedhojë, nuk u cenua afati maksimal i hetimeve paraprake. Sidoqoftë, mosshënimi në regjistër i emrit të personit që mbart këtë cilësi, sipas Kodit të Procedurës Penale, analizuar edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 6/2024, i krijon subjektit hapësira që në mënyrë të padrejtë të zvarrisë afatet me justifikimin se vepra penale është pa autor. Gjykata Kushtetuese në vendimin e referuar, ka arsyetuar se është përgjegjësia e prokurorit që të udhëheqë hetimet dhe policinë gjyqësore në drejtim të zbulimit të autorit të veprës penale.

11.12. Në rastin konkret nuk paraqiten arsye të cilat mund të justifikojnë mosshënimi e personit që i atribuohet vepra penale deri në përfundim të hetimeve, në kushtet kur, sikurse referon denoncuesi, ata paraqitën kallëzimin në emër të personave të caktuar. Ky mosveprim i subjektit tregon më së paku, qëllimin për t'iu shmangur afateve të përcaktuara në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale dhe një zvarritje të panevojshme të hetimit. Subjekti kishte të gjithë mundësinë që të shënonte në regjistër emrin/emrat e personave që iu atribuua vepra penale, në mënyrë që të kryente një hetim sa më efikas dhe në respektim të afatit procedural, duke penguar kështu edhe vijimin e tjetërsimit në mënyrë të padrejtë të pronave. Në këtë mënyrë, që në momentin që u regjistrua procedimi, apo kur u administruan aktet e institucioneve, ashtu sikurse u evidentua edhe u konstatua nga akti i ekspertimit të datës 05.02.2020, subjekti kishte mundësinë/detyrimin e shënimit të emrit në regjistër, në mënyrë që të kryeshin verifikimet në drejtim të afateve të hetimeve paraprake, me konsideratë edhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Zbatimi i këtij detyrimi, vlerësohet në aspektin e aftësive organizative të subjektit, për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje sipas pikës 4, të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016³⁰.

11.13. Në mënyrë kumulative, në të tria rastet e trajtuara më lart që lidhen me veprën penale të falsifikimit të dokumenteve dhe të shpërdorimit të detyrës, me fokus shpërdorimin e detyrës, që

Lartë të Drejtësisë, Kryetari të Bashkisë [...] ç. Akuzat Penale kundër ish funksionarëve të mësipërm, kur vepra penale është kryer gjatë ushtrimit të detyrës”.

³⁰ *Kjo dispozitë parashikon: “[...] 4. Në rastin e prokurorit, aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit”.*

Komisionerja Publike pretendon se *mungesa e ndëshkimit* nga subjekti, ndikon në besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

11.14. Nga kontrolli i kryer në Kolegj në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues vlerësoi se përpos afateve hetimore që janë pothuajse në limitet e kohëzgjatjes maksimale (2-vjeçare), në dy rastet e para, analizuar më lart në këtë vendim, subjekti ka vlerësuar se ish-zyrtarët kishin konsumuar elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, por ndjekja e tyre nuk mund të ushtrohej për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Në asnjërin prej rasteve, afatet e parashkrimit nuk u plotësuan për shkak se subjekti zgjati hetimet paraprake. Në rastin e tretë, subjekti konstatoi se ish-Kryetari i Bashkisë Lezhë, në vitin 2016, kishte konsumuar veprën penale të shpërdorimit të detyrës, dhe për mungesë kompetence e dërgoi çështjen pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda³¹.

11.15. Sikurse evidentohet në shkresën përcjellëse të informacionit nga Prokuroria Lezhë, aktet e këtij procedimi janë dërguar pranë Prokurorisë së Posaçme për shkak se njëri nga personat nën hetim ishte ish-Kryetari i Bashkisë Lezhë dhe dosja u transferua për mungesë kompetence, ndërsa në Komision u administrua vetëm vendimi i subjektit për kalimin e akteve. Në këto kushte, në fashikujt e përcjellë në Kolegj, është administruar vetëm vendimi i subjektit për kalimin e akteve Prokurorisë së Posaçme. Nuk rezulton që Komisioni të ketë kërkuar informacion në Prokurorinë e Posaçme për këtë rast. Nga kontrolli në faqen e Gjykatës së Lartë, konstatohet se ish-Kryetari i Bashkisë Lezhë [z. F. F.] në vitin 2024 është dënuar nga Gjykata e Posaçme për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, si dosje e transferuar në vitin 2019, nga Gjykata për Krimet e Rënda.

12. *Denoncimi anonim që lidhet me procedimin penal nr. {***}/2018:*

12.1. Komisionerja Publike kërkon që gjetjet në rezultatet e hetimit t'i nënshtrohen juridiksionit kontrollues të Kolegjit sipas nënindikatoreve të neni 73 të ligjit nr. 96/2016 dhe të vlerësohen në referencë të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, më së paku, analiza dhe arsyetimi logjik i prokurorit mbi aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal në referimin e masës së dënimit alternativ.

12.2. Denoncuesi ka paraqitur në Komision informacion lidhur me kërkesën e subjektit në aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, në çështjen ndaj të pandehurit A. R. Në çështjen objekt shqyrtimi, i pandehuri ishte i akuzuar për veprën penale të “vjedhjes” dhe të “prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike”. Sipas denoncuesit, nuk mund të kërkohej zëvendësimi i dënimit me burg me vënien në provë, për shkak se i pandehuri paraqiste rrezikshmëri të lartë shoqërore për faktin se akuzohej njëkohësisht për dy vepra penale, ashtu sikurse edhe për faktin se pasi u lirua ai vrau një punonjës të policisë për shkak të detyrës.

12.3. Mbi bazën e kallëzimit të znj. A. S., në datën 31.7.2018, është regjistruar procedimi penal nr. {***}/2018, në ngarkim të z. A. R.³². Kallëzuesja e akuzonte z. A. R. për vjedhje – pasi i kishte

³¹ P.sh.: Në procedimet e tjera që u konstatuan në faqen e Gjykatës së Lartë, ai që u sipërcitua, Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë dhe Gjykata e Apelit Shkodër, e kanë dënuar ish-Kryetarin e Bashkisë Lezhë, F. F. pa e dërguar në gjykatën kompetente. “2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. {***}, datë 17.09.2020, ka vendosur: 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit F. F. për kryerjen e veprës penale të parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal e në bazë të kësaj dispozite e dënon me 4 vite burgim, si dhe në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, t'i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 4 vitesh;”

³² Nga informacionet në burime të hapura në internet, konstatohet se në vitin 2021 z. A. R. ka vrarë një punonjës të policisë Lezhë dhe më pas ka vrarë veten.

marrë aparatën celular – për prodhim dhe shitje të lëndës narkotike, si dhe për “nxitje për përdorimin e drogës” *cannabis sativa*³³. Gjithashtu, nga ekspertimit toksikologjik dhe mjekoligjor, e dëmtuara/kallëzuesja ka rezultuar me dëmtime trupore, për shkak të rrahjes dhe dhunës së ushtruar nga i pandehuri me mjete të forta mprehëse, si dhe ka rezultuar prania e lëndëve narkotike në organizmin e saj.

12.3.i. U provua gjatë hetimit të prokurorisë/subjektit, se z. A. R. dhe znj. A. S. kishin marrëdhënie të posaçme, ishin të dashur, kishin konsumuar lëndë narkotike *cannabis sativa*, dhe se z. R., pa pëlqimin e saj, i ka marrë aparatën celular, ndërsa vepra penale e “nxitjes për përdorimin e drogës”, e parashikuar nga neni 286/1 i Kodit Penal, nuk u arrit të provohej. I pandehuri R. u arrestua dhe u mbajt me masën e sigurimit arrest me burg me vendimin e gjykatës datë 1.8.2018.

12.3.ii. Në datën 4.10.2018, subjekti i ka kërkuar akte ekspertimi Institutit të Policisë Shkencore Tiranë. Në zbatim të nenit 246/6³⁴ të Kodit të Procedurës Penale, në datën 3.10.2018 subjekti ka informuar me shkrim gjykatën për gjendjen e procedimit dhe se ndodhen në të njëjtat kushte, dhe nuk gjenden përpara rastit të ndryshimit të masës së sigurimit. Konkretisht, subjekti ka informuar gjykatën në lidhje me hetimet e kryera gjatë afatit 2-mujor nga zbatimi i masës së sigurimit ndaj të dyshuarit, duke referuar se akti i ekspertimit mbi lëndën e dyshuar *cannabis sativa* nuk është administruar nga Prokuroria. Po ashtu, nga akti i ekspertimit në trupin e kallëzueses janë konstatuar shenja dhune, e se ajo ka qenë nën ndikimin e narkotikëve. Subjekti ka informuar drejtuesin e prokurorisë se çështja ishte në fazën e hetimeve intensive, ku provë mbeten ato shkencore, një pjesë e të cilave janë administruar dhe priten të administrohen dhe akte të tjera kimike dhe biologjike nga Instituti i Policisë Shkencore, Tiranë. Në datën 8.10.2018, Instituti i Policisë Shkencore ka dërguar rezultatet e objektit të ekspertimit (sipas vendimit të datës 3.8.2018, dërguar për ekspertim në datën 8.8.2018). Në muajin tetor subjekti ka vijuar me marrjen e të dhënave nga personat që kanë dijeni për veprën penale. Në datën 29.10.2018, subjekti ka mbajtur një procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale/kallëzuesja, e cila ka deklaruar se kallëzimin e bëri: *nga veprimet e paduruara të saj ndaj z. A. R. [...]*, e gjithashtu deklaroi se: *katër muajt e fundit të lidhjes e rrihte edhe për gjënë më të vogël [...]*. Ajo deklaroi se: *dy muajt e fundit, pa dëshirën e saj, i pandehuri i mësoi edhe cigaren dhe hashashin.*

12.3.iii. Në datën 13.12.2018, me vendim, subjekti mori të pandehur dhe i komunikoi akuzën z. A. R. për veprën penale të “vjedhjes” dhe të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, në formën e mbajtjes, ndërsa konkludoi se vepra penale e “nxitjes për përdorimin e drogës” nuk provohet. Në datën 14.12.2018, subjekti ka njoftuar përfundimin e hetimeve dhe dërgimin e kërkesës për gjykim, pra pas 4 muajsh.

12.3.iv. Në bisedimet përfundimtare përpara gjykatës, në lidhje me alternativën e dënimit, sipas nenit 59 të Kodit Penal³⁵, subjekti ka arsyetuar se plotësohen elementet e parashikuar nga kjo

³³ *Kallëzuesja ka deklaruar pranë prokurorisë së i dashuri i saj A. R. e ka nxitur duke e detyruar vazhdimisht të konsumojë cigare me lëndë narkotike, pasi në të kundërt e rrihte.*

³⁴ “6. Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Informacioni përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit.”

³⁵ Neni 59, “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”: “1. Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së

dispozitë, pasi: (i) konstatoi qëndrim pohues të të pandehurit por edhe pendues, në të njëjtën kohë e lidhur kjo edhe me marrëdhëniet me kallëzuesen; (ii) mosha e të pandehurit, i cili i ka kryer veprat penale sapo ka mbushur moshën 18 vjeç; (iii) fakti që nuk ka qenë në kujdesin, rritjen e zhvillimin e prindërve, pasi ata ishin të divorcuar qëkur i pandehuri ishte 12 vjeç; (iv) qëndrimi që ka mbajtur gjatë fazës së hetimeve apo dhe në kohën e paraburgimit; (v) sasia e lëndës narkotike shumë e vogël sikur rezulton nga akti i ekspertimit; (vi) fakti që ka qenë përdorues i lëndës narkotike; (vii) qëndrimi i tij lidhur me përdorimin e kësaj lënde; (viii) kontakti me kallëzuesen gjatë kohës së burgimit dhe që nuk i kanë kujtuar njëri-tjetrit situatën; si dhe fakti që (ix) i pandehuri është shprehur se ka nxjerrë mësim nga kjo kohë qëndrimi në kushtet e paraburgimit, kushte e kritere të parashikuara nga nenet 47 – 49 të Kodit Penal. Subjekti i kërkoi gjykatës që i pandehuri të deklarohet fajtor për veprën penale të vjedhjes dhe të dënohet me tre muaj burgim, dhe fajtor për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, në formën e mbajtjes, dhe të dënohet me pesë vite burgim. Sipas subjektit, në aplikim të nenit 55³⁶ të Kodit Penal, dënimi është 5 vjet burg, dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale [gjykimi i shkurtuar], dënimi është tre vjet e katër muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, subjekti kërkoi pezullimin e ekzekutimit të dënimit për pjesën e mbetur pa vuajtur, duke e lënë me kusht për një afat 1 vit e 8 muaj.

12.3.v. Me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë nr. {***}, datë 18.3.2019, i vënë në dispozicion nga denoncuesi, konstatohet se gjykata ka pranuar kërkimet e subjektit dhe ka arsyetuar se plotësohen rrethanat në favor të lehtësimit të dënimit, që gjykata mbajti në konsideratë: (i) nuk ka qenë më parë i dënuar; (ii) në momentin e kryerjes së veprës penale, sapo kishte mbushur 18 vjeç; (iii) është rritur nga gjyshërit, me prindër të divorcuar që në vitin 2012, dhe (iv) ka shprehur pendesë për veprën penale të kryer, dhe e dënoi sipas kërkesës së subjektit.

12.4. Në vlerësim të trupit gjykues, konstatimi i Komisionit në rezultatet e hetimit që lidhet me kohën e shërbimit të provës, është i drejtë. Në pikën 4 të nenit 59 të Kodit Penal, është parashikuar se afati i vënies në shërbim prove është nga 24 muaj deri në 5 vjet dhe limitet e këtyre afateve nuk mund të ndryshohen. Në janar 2019, subjekti ka kërkuar 1 vit e 8 muaj (20 muaj) burgim për të pandehurin, që pavarësisht se është pranuar edhe nga Gjykata, vjen në kundërshtim me dispozitën ligjore. Nga verifikimi i ndryshimeve që ka pësuar norma penale në fjalë, rezulton se përpara ndryshimeve të vitit 2017, koha minimale e kërkueshme për dënimin me kusht ka qenë 18 muaj dhe maksimumi 5 vjet³⁷. Parashikimi në këtë dispozitë, para vitit 2017, mund të shpjegojë kërkesën e subjektit, dhe pranimin e gjykatës në kundërshtim me dispozitën e ndryshuar, por nga subjekti u

veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë, vjet, mund të urdhërojë, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. [...] 4. Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet [...].

³⁶ *Kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementet e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendim, gjykata më parë cakton dënimin për çdo veprë penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar. Dënimi më i rëndë i shtuar nuk mund të kapërcejë shumën e përgjithshme të dënimeve të caktuara veç e veç, as kufirin më të lartë të parashikuar për llojin e dënimit të dhënë. Kur gjykata çmon se kryerja e shumë veprave penale nuk tregon rrezikshmëri të madhe të fajtorit, mund të japë si dënim përfundimtar dënimin më të rëndë që ka caktuar për një nga veprat penale. Gjykata në vendimin përfundimtar jep një ose më shumë nga dënimet plotësuese të dhëna më vete për çdo veprë të veçantë.*

³⁷ *“Afati i provës është 18 muaj deri në 5 vjet”.*

shpjegua se moszbatimi i kësaj dispozite lidhej me ndryshimet e Kodit. Sidoqoftë, moszbatimi i kësaj dispozite, tregon mangësi të zbatimit të normës ligjore – pasi nuk mban në konsideratë ndryshimet e ligjit – apo se me vullnet nuk ka zbatuar ligjin. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime rreth mosrespektimit të afatit ligjor të kërkesës së paraqitur prej tij, dhe ky moment u mbajt në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

12.5. Në nenin 59 të Kodit Penal, në paragrafin e parë³⁸, parashikohen elementet që lejojnë aplikimin e lirit me kusht, ndër to edhe rrezikshmërinë e personit. Fakti që i pandehuri u dënua për dy vepra penale, përkundër sa pretendon Komisionerja Publike, nuk mund të argumentohet se është një element që mund të ndikojë në aplikimin e kësaj dispozite. Sidoqoftë elementi i dhunës/rrahjes, tregon shkallën e rrezikshmërisë së personit. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues nr. 2/2015³⁹, kanë interpretuar një rast të *lirit me kusht*, duke arsyetuar se elementet që duhet të mbahen në konsideratë përpara aplikimit të lirit me kusht, lidhen me natyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, e konkretisht, Kolegjet kanë theksuar se: [...] *Një vepër penale e kryer në bashkëpunim, me paramendim, apo me dhunë tregon për një shkallë të lartë rrezikshmërie të të dënuarit, çka duhet të shtyjë gjykatën për të qenë veçanërisht e kujdesshme në pranimin e kërkesës për lirim me kusht. Në këto raste, gjykata duhet të jetë pothuajse plotësisht e bindur, nëpërmjet fakteve dhe rrethanave konkrete, se i dënuari nuk do të jetë burim rreziku për shoqërinë nëse lirohet.* [...] Edhe në rastin konkret, pavarësisht se u pushuan hetimet për veprën penale të dhunës, elementi i ekzistencës së saj, ishte prezent e i pasqyruar në aktin e ekspertimit.

12.6. Në zbatim të interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara, subjekti duhet të kishte mbajtur në konsideratë se (i) i pandehuri akuzohej për tre vepra penale [pavarësisht vepra e pushuar tregonte një shkallë rrezikshmërie të ndjeshme]; (ii) ai kishte dhunuar dhe ushtruar presion psikologjik ndaj një vaje të re [edhe ajo sapo kishte mbushur 18 vjeç]; (iii) e kishte ekspozuar atë ndaj dhunës dhe substancave narkotike [në shtëpinë e të pandehurit u gjetën bishta cigare me përmbajtje lëndë narkotike]; (iv) e kishte marrë pa vullnetin e saj nga festa [dasma] dhe e kishte dërguar për të fjetur edhe në shtëpinë e xhaxhait të tij, pa lejen e atij të fundit, dhe (v) sikurse konfirmohet nga e dëmtuara, ka ushtruar dhunë në mënyrë sistematike, së paku për katër muaj me radhë [deri në denoncim]. Pra elementet e sjellës së të pandehurit, deri në atë kohë, ishin të tilla që kërkonin një analizë të kujdesshme në aplikimin e alternativës së dënimit me burgim, pasi ishin sistematike dhe të dhunshme. Subjekti duhet të kishte mbajtur në konsideratë edhe faktin që fëmijëria e të pandehurit ishte e mbushur me ngjarje të dhunës në familje. Ky fakt u konfirmua nga sjellja e mëvonshme e të dënuarit, i cili pas një viti është akuzuar për armëmbajtje pa leje dhe në vitin pasardhës kreu edhe vrasjen e një komisari në detyrë.

12.7. Për sa më lart, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të paargumentuar e të pambështetur në rrethanat e faktit, ka kërkuar aplikimin e nenit 55 të Kodit Penal, për të liruar të dënuarin nga

³⁸ “1. Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale”.

³⁹ *vendime_unifikuese_penale_1999_2015_new_1081.pdf*

burgu, duke e konvertuar në shërbim prove dhe për një afat prej 20 muajsh në zbatimin e gabuar të ligjit, pa marrë parasysh ndryshimin që kishte pësuar dispozita materiale penale, kërkoi një kohë dënimi më të ulët se ajo e parashikuar.

13. *Denoncimi i znj. P. P. që lidhet me procedimin penal nr. {***}/2020:*

13.1. Komisionerja Publike pretendon në ankim, se subjekti i rivlerësimit *sërisht* ka treguar mungesë të aftësive për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur prova. Kërkesa e pushimit të çështjes, sipas Komisioneres Publike, u përcoll pa ia nënshtruar një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimi të drejtë të ligjit, që do të lejonte përcaktimin e fajësisë së mundshme, zbardhjen e plotë të mekanizmit të ngjarjes, rolin dhe përgjegjësinë e secilit pjesëmarrës në të. Komisionerja Publike pretendon se shpjegimet e subjektit nuk ishin bindëse dhe se kjo situatë vë në dyshim thelbin e vendimmarrjes së prokurorit, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

13.2. Denoncuesja paraqet një situatë të tjetërsimit të pasurisë në mënyrë të paligjshme nga ish bashkëshorti i saj, i cili e ka shitur atë pa dijeninë e saj dhe duke qenë se ishte krijuar gjatë martesës, duhet të trajtohej si pasuri e bashkësisë. Denoncuesja ndërkohë kishte hapur edhe proces gjyqësor civil dhe kishte fituar të drejtën nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër në vitin 2018, dhe në këtë proces kishte palë edhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë (në vijim “ZVRPP Lezhë”), e cila vijoi me regjistrimin e paligjshëm të tjetërsimeve të pasurisë. Denoncuesja e ka bërë faktin e paligjshëm pjesë të kallëzimit, për veprën penale të “mashtimit”, që subjekti ka vendosur pushimin e çështjes. Sipas denoncueses prokuroria refuzon të bëjë punën e saj, pavarësisht se ajo e fitoi të drejtën civilisht.

13.3. Kallëzuesja/denoncuesja ka lidhur martesë me të kallëzuarin në datën 21.7.1994. Në datën 10.11.2009 bashkëshorti ka blerë apartamentin objekt mosmarrëveshje; në datën 2.6.2011, konstatohet se denoncuesja ka regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, kërkesë për lëshim urdhri mbrojtje ndaj bashkëshortit të saj; në datën 3.6.2011 bashkëshorti ia shiti apartamentin të motrës; në datën 21.6.2011 denoncuesja ka kërkuar lëshim të urdhrit të mbrojtjes për të dhe vajzat e saj, për shkak se kunati ushtronte dhunë; në datën 5.7.2011 denoncuesja kërkoi që të pushohet gjykimi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes ndaj bashkëshortit dhe në datën 6.10.2011 zgjidhën martesën. Në datën 27.2.2017 është finalizuar vendimi i shkallës së parë që konstatoi pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së apartamentit⁴⁰, që u la në fuqi nga vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër i datës 19.9.2018 [në datën 2.3.2018 kunata e shiti tek të tretët].

13.3.i. Për shitjen e pasurisë pa miratim të bashkëshortes, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë është regjistruar kallëzimi penal i datës 10.3.2020 i denoncueses, e cila ka kërkuar ndjekjen për veprën penale të “mashtimit”, ndaj ish bashkëshortit dhe kunatës së saj, si dhe ndjekjen penale për “shpërdorimin e detyrës”, të punonjësve të ZVRPP Lezhë që kryen regjistrimin e apartamentit të shituar pa miratimin e saj. Kallëzuesja ka parashtruar se pasuria është

⁴⁰ Për objektin e padisë që lidhet me masën e sigurimit deri në përfundim të procesit, Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë ka arsyetuar se nuk u shoqërua me garanci pasurore, ndërkohë që një kopje e padisë i është dërguar ZVRPP Lezhë, dhe në vlerësim të Gjykatës është e mjaftueshme për të mbrojtur të drejtat e paditëses duke garantuar ekzekutimin. Në të njëjtën datë, kjo gjykatë ka lëshuar urdhër ekzekutimi të vendimit që konstatoi pavlefshmërinë absolute të kontratës, ndërkohë që ZVRPP Lezhë ka regjistruar transaksione mbi këtë pasuri.

krijuar gjatë martesës dhe është shitur disa muaj para finalizimit të procedurave të zgjidhjes së martesës. Këtë çështje kallëzuesja paraprakisht e ka bërë objekt të gjykimit civil, ku ka kërkuar pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes, fakt që është pranuar nga të dy gjykatat dhe është bërë objekt ekzekutimi. Për shkak se kjo pronë është shitur më tej nga kunata te palë të treta, u pushua ekzekutimi i vendimit nga përmbarimi [evidentoj këtu që pasuria u ble në vlerën 3,4 milionë lekë, u shit tek e motra në vlerën 5,1 milionë lekë. Kallëzuesja ka pretenduar se ZVRPP Lezhë ka qenë në dijeni të veprës penale pasi ka qenë palë në procesin civil dhe nuk duhet të kryente regjistrimin e shitjes, por nëpërmjet bashkëpunimit, dhe me dashje palët arritën të shesin pjesën takuese të kallëzueses.

13.3.ii. Sipas një informacioni drejtuar kallëzueses, për hetimet e kryera deri në datën 2.10.2020, subjekti ka bërë me dije se vepra penale është regjistruar për “mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, ndërsa ZVRPP Lezhë nuk ka kthyer përgjigje rreth informacionit të kërkuar në fazën verifikuese, por më vonë. Subjekti ka informuar kallëzuesen se blerja e kësaj pasurie, është bërë vetëm nga ish bashkëshorti i kallëzueses dhe tjetërsimi është bërë pa miratimin e saj. Subjekti ka marrë në pyetje kallëzuesen, e cila ndër të tjera ka deklaruar se ajo dhe familja e saj nuk kanë jetuar asnjëherë në atë apartament. Më datë 11.3.2020 subjekti urdhëroi kryerjen e disa veprime hetimore nga OPGj-ja, deri më datë 30.4.2020. Deri në këtë datë duket se janë kryer vetëm disa veprime hetimore (*kryesisht shkresa për njoftim dëshmitarësh dhe deklarata nga personat që kanë dijeni për çështjen*) ndërsa komunikimet me institucionet shtetërore duket se janë kryer përtej datës 30.4.2020.

13.3.iii. Në datën 22.10.2020, Oficeri i Policisë Gjyqësore ka përpiluar relacionin për mënyrën e përfundimit të procedimit penal nr. {***}/2020, në të cilin parashtron se nuk gjendet përpara veprës penale të mashtimit, dhe se kjo çështje mund të zgjidhet civilisht, ku denoncuesja të kërkojë pjesën takuese në vlerë, për shkak se pasuria është tjetërsuar tek të tretët. Ai konstatoi gjithashtu se noteri nuk ka kryer ndonjë vepër penale. Për punonjësit e ZVRPP Lezhë, OPGj-ja nuk konstatoi veprime të kryera në kundërshtim me ligjin, pasi tek rubrika “bashkëpronar” në kartelën e pasurisë, nuk kishte të shënuar denoncuesen apo dikë tjetër. Për këto arsye i sugjeroi prokurorit “pushimin e procedimit penal”. Në datën 27.10.2020, subjekti ka dërguar kërkesën për pushim të hetimeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Subjekti ka arsyetuar mungesën e elementeve të veprës penale të mashtimit, sipas nenit 143⁴¹ të Kodit Penal, me qendër argumenti faktin që paratë për blerjen e shtëpisë, ish bashkëshorti ia mori hua të motrës, që më pas ia shleu duke i shitur të njëjtën pasuri, ndërsa arsyetoi se nuk gjendet përpara veprës penale të shpërdorimit të detyrës nga punonjësit e ZVRPP Lezhë, për shkak blerja e apartamentit nuk është bërë nga të dy bashkëshortët, por vetëm nga bashkëshorti i denoncueses, dhe i tillë është bërë edhe regjistrimi në ZVRPP.

13.3.iv. Gjykata e ka rrëzuar kërkesën e subjektit dhe kthyer çështjen për plotësim të hetimeve. Në këtë vendim arsyetohet se subjekti duhet të hetonte nëse bashkëshorti dhe kunata e denoncueses me anë të gënjeshtëris/shpërdorimit të besimit, kanë cenuar marrëdhënien e pronësisë, ashtu sikurse

⁴¹ Përvetësimi i pasurisë private ose publike nëpërmjet paraqitjes së fakteve të rreme ose duke fshehur fakte të vërteta, gënjeshtëris ose shpërdorimit të besimit, për vete ose persona të tjerë, përbën veprën penale të mashtimit dhe dënohet me burgim deri në pesë vjet. Kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet. Kur vepra ka sjellë pasojë të rënda dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

të hetojë nëse kanë kryer veprime të kundërligjshme duke shtie në dorë pasurinë nëpërmjet përdorimit të gënjeshtërs ose shpërdorimit të besimit. Pavarësisht se në cilësinë e blerësit paraqitet vetëm ish bashkëshorti i denoncueses, kjo pasuri u krijua gjatë kohës që palët ishin të martuara, dhe si e tillë konsiderohet pjesë e bashkëpronësisë, element ky që sipas gjykatës, subjekti nuk mbajti në konsideratë kur dërgoi kërkesën për pushimin e procedimit. Gjykata shprehet se shitja u krye gjatë kohës që marrëdhënia martesore kishte nisur të cenohej [referuar vendimeve të gjykatës për divorcin dhe urdhrat e mbrojtjes]. Gjykata la si detyrë që prokurori/subjekti të hetojë përse pikërisht gjatë acarimit të këtyre marrëdhënieve, u realizua kontrata e shitjes tek e motra e bashkëshortit të denoncueses. Po ashtu, kjo gjykatë arsyetoi nevojën e hetimit se pse pikërisht, gjatë kohës që ishte konstatuar pavlefshmëria absolute e kontratës së shitjes, e deri në gjykimin në apel, u krye shitja tek të tretët. Përsa i përket veprës penale të *shpërdorimit të detyrës*, gjykata arriti në konkluzionin se subjekti nuk ka hetuar në lidhje me qëllimin e transaksioneve të pasurisë, dhe nuk e shtriu hetimin në drejtim të verifikimit nëse nga punonjësit e ZVRPP-së janë kryer veprime në kundërshtim me ligjin, me konsideratë faktin që një ndër pikat e objektit të padisë civile ka qenë edhe sigurimi i padisë, për të moslejuar kryerjen e veprimeve juridike mbi pasurinë deri në përfundimin e gjykimit të çështjes. Në përfundim, gjykata me vendimin e datës 17.12.2020, nuk e pranoi kërkesën e pushimit dhe ia ktheu aktet subjektit, për të kryer hetimet brenda një afati tremujor. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin e datës 5.2.2021, dhe detyrat e lëna për zbatim, janë ato që ka evidentuar gjykata e rrethit.

13.4. Pasi administroi përgjigjet dhe analizoi aktet në fashikuj, sipas Komisionit, pavarësisht shpjegimeve bindëse lidhur me hetimet e kryera, dhe mosfillimin e procedimit për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, subjekti nuk ka shpjeguar pse nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore para se çështjen ta dërgonte në gjykatë për pushim. Detyrat e lëna ndaj oficerit të policisë gjyqësore nuk verifikohen plotësisht, pasi [sipas subjektit], janë dhënë verbalisht. Komisioni shprehet se për këtë çështje është vazhduar më tej hetimi nga Prokuroria e Rrethit Lezhë, pas transferimit të subjektit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Komisioni nuk është shprehur në vendim se cili ishte konkluzioni dhe analiza për veprën penale të mashtrimit për të cilën i kaloi subjektit barrën e provës.

13.5. Në datën 12.2.2020, është regjistruar kallëzimi penal i znj. P. P. në Prokurorinë Lezhë. Subjekti regjistroi këtë procedim me nr. {***}, datë 10.3.2020, vetëm për veprën penale të “mashtrimit”, ndërsa për kallëzimin që lidhje me veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, ndaj punonjësve të ZVRPP Lezhë, subjekti vendosi mosfillim procedimi. Me urdhrin e datës 11.3.2020 subjekti ka urdhëruar policinë gjyqësore që deri në datën 30.4.2020, të kryejë veprimet e hetimit pranë ASHK Lezhë, të marrë deklaratimet e të kallëzuarve, dhe ndër to ka shënuar që kunata e denoncueses të pyetet rreth arsyeve të blerjes së banesës nga i vëllai dhe arsyeja e shitjes tek pala e tretë. Me një urdhër të dytë, të datës 20.10.2020, subjekti ka urdhëruar marrjen e informacionit pranë OSHEE Lezhë, lidhur me detyrimet e abonentit familjar dhe marrjen e rideklarimeve denoncueses P. P. Në datën 27.10.2020, subjekti ka dërguar kërkesën për pushim të hetimeve, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Gjykata e ka rrëzuar kërkesën dhe e ka kthyer çështjen për plotësim të hetimeve. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër.

13.6. Nga rrjedhja e ngjarjeve, duket se i kallëzuarit ka ndërmarrë veprimet e shitjes gjatë kohës kur denoncuesja/kallëzuesja kishte paraqitur në gjykatë kërkesë për urdhër mbrojtje ndaj tij fillimisht, e më pas edhe ndaj kumatit, dhe eventualisht nisën procedurat e zgjidhjes së martesës.

Në këto kushte që paraqitet kryerja e veprimeve të tjetërsimit të pronës, subjekti kishte mundësi të hetonte në drejtim të qëllimit të vërtetë të shitjes së pasurisë nga ish bashkëshorti i denoncueses, që siç duket, ishte që kjo pasuri të mos ekzistonte në emër të tij [si pasuri e krijuar gjatë martesës] para se të zgjidhej martesja e të mos i nënshtrohej pjesëtimit për efekt të regjimit të bashkësisë, sipas nenit 74 të Kodit të Familjes⁴². Për më tepër, deklarimet e ish kunatës së denoncueses se pasurinë ia bleu të vëllait për shkak të marrëdhënies së huas/borxhit, kishte hapësira për t'u hetuar nga subjekti, në drejtim të veprime fiktive, për të konkluduar nëse gjendeshim përpara aspektit penal të mashtrimit, me konsideratë faktin që momenti i kryerjes së veprimit të shitjes përkonte me kohën kur paraqiteshin kërkesa për urdhër mbrojtjeje nga kallëzuesja. Konkretisht, pretendohet se ish bashkëshorti i denoncueses, mori borxh/hua nga e motra për blerjen e apartamentit, të cilin po ashtu ia shiti të motrës huadhënëse. Më tej huadhënësja e shiti në vlerën 1 milion lekë dhe gjatë kohës që procesi civil i konstatimit të pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes nga ish bashkëshorti tek kunata e denoncueses ishte në pritje të gjykimit në apel.

13.6.i. Në nenin 59⁴³ të ligjit nr. 32/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, i shfuqizuar, në pikën 1 parashikohej që në rast se vendosej kufizimi, ai nuk mund të zgjaste më shumë se 30 ditë. Pas kalimit të këtij afati, në rast të mosparaqitjes së një vendimi gjyqësor për marrjen e masës për sigurimin e padisë nga subjekti i interesuar, regjistruesi ishte i detyruar të hiqte kufizimin e regjistruar. Në arsyetimin që subjekti ka paraqitur para gjykatës nuk gjendet e argumentuar përse u vendos mosfillimi i hetimit për veprën penale të shpërdorimit të detyrës referuar kësaj dispozite, ashtu sikurse subjekti nuk administroi ndonjë informacion për kufizimin e pasurisë.

13.6.ii. Subjekti mund të kishte kryer hetime edhe në drejtim të verifikimit të faktit ligjor nëse pasuria e krijuar gjatë martesë mund të regjistrohej vetëm në emër të njërit bashkëshort si dhe nëse duhej një miratim/dakordësi nga bashkëshortja për kryerjen e transaksionit të shitjes nga shitësi/bashkëshorti te personi i tretë/kunata e denoncueses; ky element duhet të ishte mbajtur në konsideratë në hetimin e punonjësve të ZVRPP-së. Subjekti nuk ka kryer asnjë nga këto verifikime, ashtu sikurse janë evidentuar nga Gjykata si hetime të mangëta, e për të cilat lindi nevoja e kthimit të akteve dhe plotësimit të hetimeve.

13.7. Subjekti nuk e ka shënuar në regjistër emrin e personit që i atribuohet vepra penale, pavarësisht se kishte një kallëzim me emra konkretë, të konfirmuar edhe nga gjykatat civile se kishin shkelur ligjin. Shpjegimi i subjektit që do të *hetohej nëse ndodhej para elementeve të figurës së veprës penale, e nëse po, të vijonte me regjistrimin e emrit të personit që do t'i atribuohet kjo*

⁴² Bashkësia përbëhet nga: a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës.

⁴³ 1. Regjistruesi lëshon urdhër për regjistrimin e kufizimit në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme, me ose pa kërkesën e personit të interesuar. Ky shënim kryhet nga regjistruesi për parandalimin e mashtrimit apo veprimeve të padrejta mbi të drejtat e pronësisë të regjistruara, kur nga faktet ose dokumentacioni i paraqitur/administruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme konstatohet se drejta e pronarit për të vepruar mbi pasurinë e paluajtshme është e kufizuar. 2. Ky urdhër ndalon veprimet me këtë pasuri të paluajtshme. Një kufizim mund të zgjasë: a) për një periudhë deri në 30 ditë nga data e njoftimit; b) deri në realizimin e një ngjarjeje të caktuar, por jo më shumë se 30 ditë. 3. Akti i kufizimit lëshohet në formën e urdhrit, i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe duhet të përmbajë mjetet mbrojtëse të palëve që u drejtohet. 4. Pas kalimit të afatit 30-ditor, në rast të mosparaqitjes së një vendimi gjyqësor për marrjen e masave për sigurimin e padisë nga subjekti i interesuar, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, regjistruesi është i detyruar të heqë kufizimin e regjistruar, sipas pikës 1 të këtij neni.

vepër penale, apo në rast të ekzistencës së veprave të tjera penale dhe personave konkretë, vjen në kundërshtim me pikën 1⁴⁴ të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon emri i personit që i atribuohet vepra penale shënohet në regjistrin e njoftimeve, në të njëjtën kohë me njoftimin e veprës penale ose kur i rezulton emri, dhe nuk e lidhet me nevojën e përfundimit të hetimeve. Gjatë fazës së hetimeve, nëse subjektit do t'i dilte një fakt i ri, cilësia e personit që i atribuohet vepra penale mund të ndryshojë⁴⁵, dhe nuk lidhet në ndonjë mënyrë me qenien e të kallëzuarit jashtë shtetit.

13.8. Pas një shënimi/urdhri të dytë të subjektit, në datën 20.10.2020, që gjithsesi është tej afatit të përcaktuar në urdhrin e parë, pas më shumë se 6 muajsh, OPGj-ja ka përpiluar relacionin mbi mënyrën e përfundimit të procedimit penal. Procedimi penal u regjistrua në datën 10.3.2020, dhe OPGj-së iu la afat deri në datën 30.4.2020 për të kryer hetimet. OPGj-ja nuk e respektoi këtë afat, dhe vetëm në datën 20.10.2020, subjekti la detyra nëpërmjet një urdhri të dytë, i cili u zbatua brenda dy ditëve nga OPGj-ja që paraqiti edhe relacionin. Nga ana tjetër, kërkesa për pushim u dërgua në datën 27.10.2020, pra shtatë muaj më vonë nga regjistrimi i procedimit, ndërsa gjykata nuk e pranoi kërkesën me vendimin e datës 17.12.2020. Kjo kërkesë për pushim duhet të kishte mbajtur në konsideratë faktin që denoncuesja/kallëzuesja ishte fituese në procesin civil në të cilin u shpall e pavlefshme kontrata e shitjes. Në rastin konkret, trupi gjykues i Kolegjit vëren se fakti që kallëzuesja kishte rezultuar gjyqfituese në procesin civil, ka pasur një peshë përcaktuese në veprimet dhe mënyrën sesi e ka ndjekur subjekti procedimin penal.

13.9. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se dinamika e veprimeve dhe e drejta e mohuar denoncueses ishte vënë në vend nëpërmjet procesit civil të iniciuar prej saj për të rifituar të drejtat nga pasuria e krijuar gjatë martesës. Në këto kushte, ndonëse trupi gjykues i Kolegjit vëren se efekti fundor i këtyre mangësive nuk passillte pasoja për vetë denoncuesen, e cila kishte rezultuar gjyqfituese në procesin civil të përfunduar përpara kallëzimit penal të ushtruar prej saj, subjekti nuk rezulton të ketë marrë në pyetje e zbardhur tërësisht dinamikën e hartimit të akteve që u kontestuan si të falsifikuara, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, qoftë në ndërmarrjen e veprimeve hetimore të logjikshme, përcaktuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

14. Denoncimi i z. F. C. që lidhet me procedimin penal nr. {***}/2019:

14.1. Komisionerja Publike pretendon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk ishin bindëse dhe ai nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës. Subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë të aftësive për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore dhe veprimet e nevojshme brenda afatit të përcaktuar. Referuar nënindikatorëve të pikës 4 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, subjekti ka sjellë vonesa dhe zvarritje të çështjes që do të lexohej nga publiku si një sjellje që nuk ngjall besim te sistemi i drejtësisë.

⁴⁴ I. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.

⁴⁵ Shih vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 3/2002.

14.2. Denoncuesi parashtroi në Komision se çështja penale nr. {***}/2019 po i zvarritet mbi dy vjet dhe po pengohet nga persona të jashtëm që të arrihet në një përfundim, pavarësisht përgjigjes së Prokurorisë Lezhë se vonesa ka ardhur për shkak të pandemisë Covid-19.

14.3. Në fashikujt e Komisionit administrohet: (i) urdhri penal i datës 25.7.2019 për ngarkimin e OPGj-së për kryerjen e veprimeve hetimore procedurale, brenda datës 20.11.2019 (subjekti ka bërë shënimin: “*për shkak edhe të sezonit të pushimeve*”); (ii) urdhri për regjistrimin e procedimit penal i datës 18.7.2019 për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve; (iii) dy informacione që subjekti i ka dërguar kallzuesit; (iv) një kërkesë e subjektit e datës 27.4.2021, nëpërmjet së cilës ka kërkuar kopje të vendimeve penale gjyqësore ndaj një të pandehuri; dhe (v) informacion arkivor⁴⁶.

14.3.i. Subjekti urdhëroi regjistrimin e procedimit penal në datën 18.7.2019, për veprën e “falsifikimit të dokumenteve”, mbi bazën e kallzimit penal të bërë nga z. F. C. dhe caktoi Oficerin e Policisë Gjyqësore për kryerjen e detyrave. Nga ky urdhër mund të evidentohet se kallzuesi ka paraqitur kallzimin (të paktën) për tre persona në emër të të cilëve është regjistruar pasuria që e pretendon të tijën. Kallzuesi pretendon se këta persona, me dokumente të falsifikuara, kanë ndryshuar zërin kadastral të pasurisë së trashëguar nga babai i tij dhe e kanë certifikuar në zyrën e regjistrimit të pasurisë Lezhë, në pallate, lulishte, në periudha të ndryshme.

14.3.ii. Nëpërmjet urdhrin të datës 25.7.2019, subjekti urdhëroi kryerjen e veprimeve hetimore procedurale që përfshinin rimarrjen në pyetje të të kallzuarit, administrimin e dokumenteve nga ZVRPP Lezhë, administrimin e vendimit të vitit 1999 të Këshillit të Rrethit Lezhë, informacion pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në lidhje me parcelën në fjalë nr. {***}, deri më datë 20.11.2019 (për shkak dhe të sezonit të pushimeve).

14.3.iii. Më datë 27.4.2021, subjekti i rivlerësimit i ka komunikuar denoncuesit F. C. se kjo çështje penale është akoma në hetim, duke e informuar se: “*nisur kjo nga korrespondenca me institucionet e tjera, e ndikuar kjo dhe nga pandemia Covid-19, duke përbërë ky, gjithashtu një shkak të lidhur me ecurinë e hetimeve, pa dashur të kapemi pas kësaj situate, sidoqoftë problematikave, në çdo aspekt*”.

14.4. Për shkak të mungesës së informacionit, në rezultatet e hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime të hollësishme lidhur me hapat hetimorë të ndjekur nga ana e tij, hetimet e kryera, vonesat dhe zgjatjet e hetimeve për këtë çështje (kërkesa për zgjatje dhe miratimet përkatëse) edhe kalimit të afatit 2-vjeçar nga regjistrimi i saj.

14.5. Në përmbushje të barrës së provës subjekti është përgjigjur se policia gjyqësore ka kryer veprime në lidhje me kërkimin e dokumentacionit përkatës, administrimin e dokumentacionit posedues voluminoz prej shtetasit F. C., që kërkonte kohën përkatëse për verifikim, ndërkohë që për këtë çështje kishte problematika, vonesë solli edhe posedimi i dokumentacionit arkivor dhe verifikimi i situatës së pretenduar nga kallzuesi. Ndërkohë, subjekti shprehet se në vazhdimësi është urdhëruar policia gjyqësore për kryerjen e detyrave të tjera përkatëse, të lëna në urdhër. Është informuar kallzuesi mbi gjendjen dhe ecurinë e hetimeve. Nuk rezulton të jetë proceduar me

⁴⁶ Në shkresën që Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë i ka dërguar Komisionit informacionin, është shprehur se procedimi penal nr. {***}/2019 është në hetim, dhe ka dërguar informacion me të dhëna të kufizuara për rastin. Ky element është evidentuar edhe nga Komisioni në rezultatet e hetimit.

zgjatje afatesh hetimore, përsa kohë nuk është proceduar me regjistrim emri personi/personash që t'u atribuohet vepra penale, ndërkohë që deri në momentin që është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në bazë të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, çështja nuk ishte përfunduar.

14.6. Komisioni konkludoi në vendim se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe vlerësimi mbetet sipas rezultateve të hetimit. Subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit lidhur me vonesat dhe zgjatjet e hetimeve edhe pas kalimit të afatit 2-vjeçar.

14.7. Nga aktet që administrohen në Kolegj, [urdhri për regjistrimin e procedimit penal], evidentohet se nga momenti i regjistrimit të procedimit penal, deri në momentin që subjekti kërkoi informacion pranë Gjykatës, kaluan rreth 19 muaj dhe çështja ndodhej në fazë hetimi paraprak, e siç është përgjigjur subjekti, për këtë procedim nuk ka shënuar emrin e personit në regjistër, me pasojë mungesën e nevojës së zgjatjes së hetimeve. Gjithashtu, në shkresën e datës 2.10.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë i ka dërguar informacion Komisionit, prej të cilës konstatohet se çështja është në hetim, pra edhe pas tri vitesh, vijonte hetimi, por nuk ka informacion nëse është dërguar në gjykatë e që mund të jetë kthyer nga kjo e fundit. Sidoqoftë, shkresat e fundit që subjekti ka përpiluar për këtë rast, janë në të njëjtën ditë kur me vendimin e KLP-së nr. {***}, datë 27.4.2021, është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Për efekt përlllogaritje të afatit maksimal të hetimeve paraprake, data e largimit të subjektit përkon me rreth 21 muaj nga regjistrimi i procedimit penal në datën 18.7.2019. Në këto kushte, nuk mund të konkludohet se subjekti ka tejkaluar afatin 2-vjeçar të hetimeve paraprake, por ndërkohë që ishte në limite të arritjes së tij, pavarësisht se nuk duket që rasti paraqet problematika apo kompleksitet të një natyre që kërkon zgjatjen deri në afatin maksimal 2-vjeçar.

14.8. Për të respektuar kohëzgjatjen e hetimeve, është përgjegjës prokurori, i cili merr të gjitha masat që, në bashkëpunim me policinë gjyqësore, për efekt të kryerjes së një hetimi të drejtë dhe efikas, brenda periudhës së hetimeve paraprake të ndërmarrë të gjitha veprimet për zbulimin e autorit/personit që i atribuohet vepra penale⁴⁷.

14.9. Në konsideratë të pikave 2 dhe 4 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, parashikohet që aftësia organizative e prokurorit vlerësohet në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë, duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të prokurorisë për një çështje. Në pikën 4, përcaktohet se ky vlerësim matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit. Subjekti nuk ka arsyetuar se cila ka qenë ngarkesa me rastet, apo kompleksiteti i çështjes që e detyroi që hetimi të kishte një kohëzgjatje të tillë.

14.10. Në kushtet e sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vonesa të panevojshme në fazën e hetimeve paraprake, që sugjeron për mangësi në drejtim të ndërmarrjes së hetimeve logjistikisht brenda afatit të arsyeshëm. Sidoqoftë, u vërejt se ky procedim përkon me mbylljen për shkak të masave të jashtëzakonshme të pandemisë së Covid-19, të volumit

⁴⁷ Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 6/2024, paragrafi 29.

të dokumentacionit që nevojitej për hetimet dhe të ngarkesës që iu shtua për shkak të procesit të rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues e gjeti pa ndonjë peshë domethënëse vonesën në hetime, në kushtet kur ishte brenda afateve të hetimeve paraprake, dhe motivohej nga rrethanat e sipërshënuara.

15. *Denoncimi i z. A. S. që lidhet me kallëzimin penal nr. {***}/2019:*

15.1. Komisionerja Publike, pretendon se edhe në këtë procedim penal, subjekti ka treguar mungesë të aftësive për të ndërmarrë logjikisht hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke passjellë paraqitjen e kërkesës për pushim, pa ia nënshtruar një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimi të drejtë të ligjit, që do të lejonte përcaktimin e fajësisë së mundshme, zbardhjen e plotë të mekanizmit të ngjarjes, rolit dhe përgjegjësisë të secilit pjesëmarrës në të. Sipas ankimit të Komisioneres Publike, kjo situatë faktike vë në dyshim thelbin e vendimmarrjes së prokurorit për akuzat e personave të përfshirë në procedimin penal, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Komisionerja Publike konkludon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, ashtu siç ka vlerësuar edhe Komisioni, nuk ishin bindëse.

15.2. Denoncuesi kërkon që rasti i tij të vlerësohet nga organet e drejtësisë, pasi në mënyrë të qëllimshme subjekti zvarriti procesin penal, që mund të çojë në vetëgjyqësi.

15.3. Pas administrimit të shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerësoi në vendim se subjekti nuk ka kryer hetime të plota dhe ka tejkalar afatin hetimor katërmujor të caktuar nga Gjykata për kryerjen e veprimeve. Komisioni konkludoi se duke mos e ankimuar vendimin e Gjykatës, subjekti ra dakord me të, si dhe nuk dha shpjegime dhe argumente bindëse përse nuk u zbatuan detyrat brenda afatit të caktuar, si dhe pse nuk është kërkuar zgjatje e afatit të hetimeve.

15.4. Në datën 16.5.2019, z. A. S. paraqiti kallëzim penal ndaj punonjësve të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive Lezhë, për regjistrime të kundërligjshme; ndaj Kryetarit e dy punonjësve të Bashkisë Lezhë, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve e shpërdorimit të detyrës nëpërmjet dhënies së lejes së ndërtimit në kundërshtim me vendimet e KRrT Lezhë vëllezërve P.; mosregjistrimin e vendimit të KRrT Lezhë dhe të gjykatës në ZVRPP Lezhë; mospastrim të inerteve të dy kasolleve të prishura nga INUK dhe Bashkia Lezhë; si dhe ndaj z. P. P., Gj. P. dhe Gj. P. (fqinjë të kallëzuesit) për veprën penale të falsifikimit e tjetërsimit të pronave shtetërore dhe të kallëzuesit, konkretisht të një pjese të rrugës së kalimit dhe të spostimit të murit rrethues kufizues mes dy pronave me 5 metër thellësi. Kallëzuesi ka pretenduar se prej 11 vitesh është në konflikt pronësie me familjen P. për pjesën e rrugës në të cilën kalon. Kallëzuesi është shprehur se pavarësisht konfirmimit nga gjykata të së drejtës së tij, është penguar nga vëllezërit P. për ekzekutimin e vendimit. Ai pretendoi se është kryer regjistrim i kundërligjshëm i pronës shtetërore dhe të pronës së tij pa shpjeguar origjinën e pronës, si dhe është dyfishuar sipërfaqja që vërtetohet nga arkiva e Bashkisë Lezhë dhe nga vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

15.5. Nga aktet, konstatohet se më datë 10.6.2019, me urdhër të subjektit, është regjistruar procedimi penal nr. {***}/2019, pas administrimit të kallëzimit penal nr. {***} datë 27.5.2019, për veprat penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal. Ky regjistrim është bërë pa emër personi të regjistruar që i atribuohet vepra penale. Në datën 14.6.2019, u urdhërua kryerja e disa veprimeve hetimore nga OPGj, deri në datën 20.7.2019. Përgjatë periudhës 5.6.2019 – 20.7.2019 u kryen disa veprime

hetimore dhe korrespondenca me institucione të ndryshme, hetime të cilat kanë vazhduar përgjatë vitit 2019. Në datën 16.1.2020, subjekti ka urdhëruar këqyrjen në vend të rrugës dhe të murit rrethues kufizues midis dy pronave, si dhe urdhëroi që të kryhet edhe ekspertimi topografik. Pas këtyre veprimeve, në datën 10.4.2020, OPGj-ja përpiloi relacionin për përfundimin e hetimeve të procedimit penal. Në përfundim të këtij relacioni, OPGj-ja sugjeroi “pushimin e hetimeve të procedimit penal”, për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve dhe të shpërdorimit të detyrës.

15.6. Në datën 16.4.2020, subjekti paraqiti përpara gjykatës kërkesën për *pushimin e hetimeve të procedimit penal*, me arsyetimin se regjistrimi i kryer nga ZVRPP Lezhë i këtyre pronave është sqaruar nga specialistja e ZVRPP Lezhë që u mor në pyetje, e që ka hartuar shkresën që dispononte denoncuesi [në të cilën ishte shënuar se të kallëzuarit nuk kishin pasuri të regjistruar]. Specialistja ka sqaruar se përgjigjja e ZVRPP Lezhë është bazuar në të dhënat e nxjerra nga sistemi digjital, ndërkohë që kjo pasuri është e regjistruar manualisht dhe nuk është hedhur në sistem. Sipas deklarimeve të saj, në ZVRPP Lezhë ka zona kadastrale dhe pasuri që nuk janë pjesë e sistemit dhe janë të hedhura/plotësuar manualisht në regjistrat e pasurive. Më tej subjekti arsyetoi në kërkesën e pushimit edhe se regjistrimi u krye nga ZVRPP Lezhë në përputhje me VKM nr. 745/2012⁴⁸, pasi Gj. P. paraqiti notën e transkriptit të vitit 1963 në favor të N. P./P. Gjithashtu ai arsyetoi se për regjistrimin janë paraqitur të gjithë dokumentet e nevojshme. Subjekti ka marrë edhe *deklarimet me interes për procesin* nga palë të tjera për verifikimin e sipërfaqes, nga ku një punonjëse e ZVRPP Lezhë që kreu regjistrimin ka sqaruar se prona përputhej me pronat kufitare dhe se nuk ka mbivendosje. Ndërsa subjekti ka marrë në pyetje edhe noterin pranë të cilit është hartuar deklarata noteriale e pronarit kufitar z. D. F., i cili deklaroi se e njihte personalisht deklaruesin, e se në momentin e hartimit të deklaratës ka qenë në gjendje të rënduar shëndetësore, por i përgjegjshëm. Ndërsa bashkëshortja e pronarit kufitar deklaroi se nuk e njeh kallëzuesin dhe nuk ka dijeni për veprimet që mund të ketë kryer bashkëshorti i ndjerë. Nga akti i ekspertimit i vitit 2020, është evidentuar se vendndodhja, sipërfaqet dhe kufizimet përputhen me të dhënat sipas certifikatës së pronësisë, hartat treguese të regjistrimit dhe kartelat e pasurisë për pasuritë objekt hetimi.

15.7. Pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit, me vendimin e formës së prerë të datës 21.10.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, vendosi mospranimin e saj, dhe ktheu aktet në Prokurori për plotësim të hetimeve. Gjykata kërkoi që brenda një afati 4-mujor hetimi të drejtohet drejt ZVRPP Lezhë, për të konstatuar procedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurive; kryerjen e një akti të ri ekspertimi teknik për të sqaruar rrethanat lidhur me ekzistencën ose jo të mbivendosjes së pronës dhe të kryerjes së hetimit në drejtim të falsitetit të dokumentit “deklaratë e pronarit kufitar” të z. D. F. Gjykata arsyetoi se hetimet nuk janë kryer të plota në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve të punonjësve të ZVRPP Lezhë, pasi regjistrimi i pasurisë është kryer pa përcaktuar sipërfaqen, dhe ekziston dyshimi që regjistrimi i pronës në emër të familjes P. të jetë kryer me mbivendosje. Sipas arsyetimit të Gjykatës duhet të kryhet edhe akti i ekspertimit për të verifikuar nëse rruga e kalimit është krijuar pas notës së transkriptit apo ka qenë e tillë *që në momentin e saj* dhe regjistrimi i pronës sipas këtij pozicionimi është bërë në kundërshtim me ligjin. Vendimi i Gjykatës u administrua në Prokurori në datën 17.12.2020, ndaj të cilit subjekti nuk ushtroi ankim, por urdhëroi

⁴⁸ Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë përcaktuar sipërfaqen.

oficeren që të kryente detyrat e lëna nga Gjykata, si dhe të administrohej materiali pranë ZVRPP-së Lezhë.

15.8. Në datën 8.4.2021, subjekti këqyri dokumentet që administrohen në zyrën e ZVRPP Lezhë, dhe urdhëroi OPGj-në të përsëritet akti i ekspertimit. Në datën 12.5.2021 OPGj-ja mori praktikat nga ZVRPP Lezhë dhe në datën 19.5.2021 caktoi detyrat e eksperteve. Në shtator të vitit 2021, është hartuar akti i ekspertimit, pra pasi subjekti është transferuar në Prokurorinë e Tiranës. Gjithashtu, edhe disa kthime të përgjigjeve dhe veprimet e tjera hetimore, janë kryer pasi subjekti u transferua në Tiranë. Nga momenti kur vendimi i Gjykatës mori formë të prerë dhe u dërgua në prokurori deri në datën 8.4.2021, subjekti ka kryer disa veprime hetimore. Në aktet që lidhen me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm të regjistrimit të pasurisë, subjekti e përqendroi hetimin në drejtim të vërtetësisë dhe saktësisë së akteve të paraqitura nga të kallëzuarit P. për regjistrimin e pasurisë, bazuar edhe në konkluzionet e aktit të ekspertimit. Sikurse është shënuar më lart, subjekti ka kryer veprime të tërheqjes së praktikave nga ZVRPP-ja, të këqyrjes së vendimit të ngjarjes, të kryerjes së aktit të ekspertimit, si dhe të marrjes në pyetje të personave që kanë dijeni për veprën penale. Për pasuritë objekt hetimi, në aktin e ekspertimit të vitit 2020, është evidentuar se vendndodhja, sipërfaqet dhe kufizimet përputhen me të dhënat sipas certifikatës së pronësisë, hartat treguese të regjistrimit dhe kartelat e pasurisë.

15.9. Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se pretendimi i Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit nuk kreu hetime të plota e të gjithanshme *nuk* qëndron. Nga kontrolli i akteve në fashikuj, trupi gjykues nuk evidentoi të pasqyrojnë arsyetime të gabuara, paaftësi për të ndërmarrë hetimin, mungesë hetimesh apo zvarritje që kanë dëmtuar interesat e palëve. Nga analiza e veprimeve hetimore që rezultojnë nga aktet në fashikull dhe shpjegimet në proces, rezulton që subjekti të ketë kryer hetime të gjithanshme për të zbardhur dinamikën e ngjarjeve, administruar akte, pyetur personat që kishin dijeni, dhe sipas rastit, disponuar e administruar edhe akt-ekspertime për të qartësuar nëse pretendimet e kallëzuesit provonin rrethanat që pretendonin vepër penale.

16. *Denoncimi anonim nr. {***}, datë 27.1.2022:*

16.1. Komisionerja Publike, pretendon se rrethanat e rastit duhet të ishin marrë në konsideratë nga Komisioni dhe të kërkoheshin shpjegime nga subjekti. Sipas Komisioneres Publike, edhe këto rrethana duhet të vlerësohen së bashku me gjetjet e tjera në referencë të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

16.2. Në një denoncim anonim të paraqitur në Komision, me emrin “polici i burgut”, është paraqitur ngjarja e transmetuar nga emisioni investigativ “{***}”, në vitin 2019. Denoncuesi i parashtroi për Komisionin këto rrethana si veprimtari korruptive të subjektit, nëpërmjet përfitimit të shumës prej 500 eurosh⁴⁹, që duket se lidheshin me plotësimin në mënyrë fiktive të dokumentacionit të një personi, që të përfitonte azil në një shtet të huaj.

16.3. Komisioni ka vlerësuar se çështjet e pretenduara janë në kuadrin e hetimit penal dhe nuk ka *indicie* për të vlerësuar ndonjë çështje të ndjekur nga subjekti. Komisioni vendosi ja nënshtrijë hetimit të mëtejshëm administrativ këtë denoncim dhe nuk i kaloi subjektit barrë prove. Subjekti

⁴⁹ {***}.

nuk mbajti qëndrim për rastin në rezultate të hetimit, dhe në vendim Komisioni arsyetoi njëllë si në rezultatet e hetimit për këtë rast.

16.4. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare, parashtrori se ky denoncim nuk përmban të dhëna apo indicie që të lidhë subjektin e rivlerësimit me veprimet e pretenduara.

16.5. Në kushtet që për subjektin nuk disponohen të dhëna qoftë edhe nga organet ligjzbatuese për të treguar ndonjë implikim të mundshëm të tij, apo çfarëdo të dhënash për ndonjë veprimtari korruptive apo ndonjë proces penal të mundshëm për subjektin, që do ta bënin atë të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, trupi gjykues vlerëson se denoncimi nuk përmban të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar shkëlqen ligjore e për hetim të mëtejshëm. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të pamotivuar pretendimin e Komisioneres Publike në ankim që këtë çështje t’ia nënshtrojë hetimit.

B.II. Si konkluzion në lidhje me vlerësimin tërësor

16.6. Komisionerja Publike e ka pranuar balancën negative të konstatuar në Komision për periudhën 1993 – 2016 në masën (-) 765.210 lekë, për subjektin e rivlerësimit Arben Agovi, si një pamundësi financiare për shtimin e pasurive dhe likuiditeteve, dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera. Për kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar se ka arritur një nivel të besueshëm, dhe ky kriter nuk është shkak ankimi nga Komisionerja Publike. Ajo kërkon që të kryhet një vlerësim tërësor⁵⁰ i mangësive në vlerësimin e aspektit profesional, së bashku me balancën negative të konstatuar nga Komisioni, bazuar në pikën 5⁵¹ të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

16.7. Një kontroll i mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit u krye edhe në Kolegji, në drejtim të metodologjisë dhe saktësisë së rezultatit të Komisionit. Nga ky kontroll u konstatua se për periudhën e rivlerësimit dhe para vitit 2003 subjekti i rivlerësimit rezulton me një bilanc negativ total në vlerën: **(i)** (-) 395.623 lekë sipas variantit bazuar në deklaratimet e subjektit mbi gjendjen *cash* ose **(ii)** (-) 765.210 lekë sipas variantit të llogaritur nga Komisioni.

16.8. Nga kontrolli i vendimit të Komisionit për subjektin e rivlerësimit Arben Agovi, konstatohet se balanca negative, në respekt të jurisprudencës së Kolegjit, është e tillë që lejon aplikimin e parimit të proporcionalitetit, pasi nuk është e aftë të sjellë e vetme masën disiplinore të shkarkimit të subjektit nga detyra.

16.9. Për kriterin e kontrollit të aftësive profesionale, në 8 (tetë) rastet e kontrolluara, në mënyrë të përmbledhur, u konstatua se subjekti e respekton afatin 2-vjeçar të hetimeve paraprake për veprat penale pa autor. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit nuk vërejtë se këto afate të kenë sjellë pasoja të pariparueshme për denoncuesit, ashtu sikurse nuk gjeti elemente që lidhen me mangësi në hetime, të konfirmuara edhe nga kontrolli gjyqësor i ushtruar ndaj kërkesave të

⁵⁰ “2. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

⁵¹ “5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”.

subjektit. Sidoqoftë, trupi gjykues i Kolegjit mbajti në konsideratë se çështjet e trajtuara në këtë vendim si pretendime ankimi⁵², janë të regjistruara pasi ka nisur procesi i rivlerësimit, konkretisht nga viti 2018 e deri në vitin 2020. E thënë ndryshe, periudha e hetimeve dhe zbatimi i afateve të hetimit, lidhet edhe me kohën kur nisi procesi i rivlerësimit kalimtar, e që filloi të zbalancojë ngarkesën e punës së subjekteve të rivlerësimit që ishin në detyrë duke e rritur ndjeshëm atë.

16.10. Nga ana tjetër, konstatimet e këtij vendimi, në aspektin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, nuk ishin të një rëndësie që mund të sjellin cenim të rëndë dhe të pakthyeshëm të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë⁵³. Aftësitë e subjektit për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligjin nr. 84/2016 dhe me referim për procedurat e vlerësimit nga ky i fundit, edhe në ligjin nr. 96/2016⁵⁴, u vlerësuan së bashku me mangësinë e burimeve financiare të konstatuar nga Komisioni. Këto konstatime u vlerësuan të tilla që nuk mund të sjellin cenimin e besimit të publikut tek drejtësia, me pasojë shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerësoi se sjellja profesionale e subjektit, nuk paraqet mangësi apo cenim të besimit të publikut të drejtësia në ndonjë formë, gjithashtu nuk mund të ngrihen as në nivelin që të lindin nevojën e pezullimit nga detyra të subjektit në mënyrë që të metat e konstatuara të shërohen nëpërmjet programit njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës.

17. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje edhe që marrja e masës disiplinore të pezullimit dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit duket i panevojshëm pasi aktet e administruara në procesin e rivlerësimit nga Komisioni evidentojnë se subjekti ndërmerri logjikisht hetimin, sikurse edhe nxjerr urdhra, merr vendime, mbledh prova, interpreton ligjin dhe analizon jurisprudencën në mënyrë rigorozë. Subjekti pasqyron një mënyrë pune që tregon kujdes t'i përshtatë veprimet me nevojat e hetimit, përfshirë edhe marrjen në pyetje të personave të përfshirë në ngjarje, apo edhe duke mos u kufizuar në konkluzionet e paraqitura nga Oficeri i Policisë Gjyqësore. Po ashtu, për nga forma, aktet e përpiluara prej tij rezultojnë të qarta dhe kanë strukturë të mirë-organizuar. Për rrjedhojë, mangësitë e konstatuara edhe në këtë këndvështrim nuk nevojitet të korrigjohen nëpërmjet trajnimit, përpos sa u arsyetua më sipër, për peshën që ato çmohen të marrin.
18. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se mangësitë e konstatuara në kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në kontekstin e ushtrimit të detyrës për mbi 20 vite, nuk mund të argumentohen se e kualifikojnë atë si “të papërshtatshëm”, dhe as diktojnë nevojën e plotësimit të mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Për rrjedhojë, nën dritën e nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 44, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, në kushtet që subjekti i rivlerësimit vlerësohet “i aftë” në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale dhe balanca negative e konstatuar sikurse parashtruar edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mbetet nën nivelin që lejon zbatimin e parimit të proporcionalitetit të masës, vendimi nr. 724, datë 13.12.2023

⁵² (1) procedimi penal i rifilluar nga subjekti në datën 3.4.2019, me nr. {***}/2016 [N. K.]; (2) procedimi penal nr. {***}/2018 [E. K.]; (3) procedimi penal nr. {***}/2019 [Gj. C.]; (4) procedimi penal nr. {***}/2018 [A. R.]; (5) procedimi penal nr. {***}/2020 [P. P.]; (6) procedimi penal nr. {***}/2019 [F. C.]; dhe (7) kallëzimi penal nr. {***}/2019 [A. S.].

⁵³ Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 29/2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Ndriçim Troplini.

⁵⁴ Shih paragrafin 65 të vendimit të Kolegjit (JR) nr. 46/2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri.

i Komisionit, që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 724, datë 13.12.2023 që i përket të subjektit të rivlerësimit Arben Agovi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 12.11.2025.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi